

LIRIA E VOTËS dhe VOTIMI FAMILJAR në SHQIPËRI

Hulumtim kombëtar
2014



Ekipi i Autorëve - IDRA

Auron Pasha
Enfrid Islami
Jorida Dervishi
Pjerina Dodbiba
Fajket Agalliu

Ekipi i Koordinatorëve të Sondazhit

Esjona Kryemadhi
Fatjola Gora
Ela Koci
Fjorinda Lazi
Suela Dokaj

Ekipi i Analistëve të të dhënave

Tedi Coka
Pjerina Dodbiba
Elvis Bektasha

Konsulente – PhD. Klea Faniko

Viti i Publikimit - 2014

© Instituti Për Kërkime Dhe Alternativa Zhvillimi - IDRA

UN WOMEN

UN Women është organizata e **Kombeve të Bashkuara** kushtuar barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave. Përkrahëse botërore për gratë dhe vajzat, UN Women është themeluar për të përshpejtuar progresin dhe përmbushjen e të drejtave të grave në të gjithë botën.

UN Women vepron nën bindjen themelore se gratë dhe vajzat kudo në botë kanë të drejtën e një jete pa diskriminim, dhunë dhe varfëri dhe se barazia gjinore është në qendër të arritjes së zhvillimit.

Barazia gjinore nuk është vetëm një nga të drejtat themelore të njeriut, por duke fuqizuar gratë në vendet në zhvillim, nxit produktivitetin dhe sjell rritje ekonomike.

Instituti Për Kërkime Dhe Alternativa Zhvillimi - IDRA

IDRA është një think tank jo-fitimprurës, jo-qeveritar, dhe i pavarur, i themeluar nga një grup ekspertësh në vitin 2000. Si një institut i politikave publike, IDRA promovon vlerat e lirisë dhe demokracisë, vlerat e ekonomisë së tregut dhe shoqërisë civile, duke i shërbyer vazhdimisht demokratizimit të shoqërisë shqiptare dhe procesit të integritimit në Bashkimin Europian.

IDRA përfaqëson një kombinim strategjik të hulumtimit dhe të një think tank-u të orientuar drejt edukimit.

SHËNIM

Ky studim është përgatitur nga Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi (IDRA) me mbështetjen teknike dhe financiare të Entit të Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Gruas (UN Women) në Shqipëri, në kuadër të programit "Lidershipi dhe Pjesëmarrja Politike". Ky program është financuar nga Qeveria Suedeze nëpërmjet Fondit të Koherencës së Kombeve të Bashkuara dhe është pjesë e "Programit të Bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 2012-2016".

Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë studim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e UN Women ose të Agjencive të Kombeve të Bashkuara

Përmbajtja

Akronimet.....	4
1. Përmbledhje Ekzekutive.....	4
2. Hyrje.....	9
2.1 Objektivat e Studimit.....	9
2.2 Konteksti i Hulumtimit.....	9
<i>Përfaqësimi dhe Pjesëmarrja e Grave në Politikë.....</i>	<i>10</i>
<i>Votimi Familjar: Përkufizimi dhe Situata Aktuale.....</i>	<i>11</i>
<i>Votimi Familjar: Korniza Ligjore Ndërkombëtare.....</i>	<i>12</i>
2.3 Metodologjia.....	14
Sondazhi Sasior.....	14
Elementi Cilësor.....	15
Marzhi i Gabimit.....	15
3. Gjetjet Kryesore - Kampioni i Popullatës së Përgjithshme.....	16
3.1 Interesi për Politikën dhe Angazhimi Civil.....	16
3.2 Votimi Familjar dhe Sjellja e Votuesit.....	19
3.3 Pjesëmarrja e Grave në Politikë.....	24
3.4 Liria e Grave.....	30
4. Gjetjet Kryesore - Kampioni Rom.....	31
4.1 Informacion i Përgjithshëm.....	31
4.2 Votimi Familjar dhe Sjellja e Votuesit.....	33
5. Rekomandime.....	37

List of Acronyms

OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë
KQZ	Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve
QV	Qendra e Votimit
ODIHR	Zyra për Institucionet Demokratike dhe Të Drejtat e Njeriut
PNUD	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
GF	Grupet e Fokusuara
AP	Anëtar Parlamenti
IDRA	Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi
NPK	Njësi Primare Kampionimi
KZAZ	Komisioni i Administrimit të Zonave Zgjedhore
OJQ	Organizata Jo Qeveritare
QHV	Qendrat e Hedhjes së Votës

1. Përmbledhja Ekzekutive

Interesi për Politikën dhe Angazhimi Civil

- Interesi mbi politikën figuron shumë i ulët për pjesën më të madhe të popullsisë, vecanërisht tek femrat. Pothuajse 1 në 3 të intervistuar (34%) nuk janë “aspak të interesuar” ndërsa 18% shfaqin nivele shumë të ulëta interesi për këto çështje (“jo shumë të interesuar”). Vetëm 18% të të intervistuarve deklarojnë se janë “shumë të interesuar” në çështjet e politikës dhe qeverisë. Ndarja sipas gjinisë, tregon qartësisht se gratë janë kryesisht më pak të interesuara në politikë (38% e grave kundrejt 29% e meshkujve që deklarojnë se nuk janë “aspak të interesuar”).
- Angazhimi civil, i matur në bazë të anëtarësimit të deklaruar të intervistuarve në organizata politike dhe sociale, është në tërësi i dobët. Vetëm 1 në 10 të intervistuar deklaron se është aktualisht anëtar i një partie, 1 në 30 të intervistuar deklarohet si pjesëtar i ndonjë organizate fetare dhe një numër i papërfillshëm figuron si pjesëtar i ndonjë organizate të shoqërisë civile/OJQ. Përfshirja e femrave në këto organizata është edhe më e ulët. Pothuajse 9 në 10 femra, në krahasim me 7 në 10 meshkuj, deklarojnë se nuk kanë qënë kurrë pjesë e ndonjë partie politike. 93% e këtyre femrave nuk kanë qënë kurrë pjesë në ndonjë organizate për gratë dhe 95% nuk kanë qënë kurrë pjesë e ndonjë OJQ-je ose grupi të organizuar në komunitet.
- Femrat shfaqin një nivel të ulët të aktivizimit civil, edhe përsa i përket përdorimit të instrumentave/metodave të ndryshme për të shprehur opinionet e tyre për çështje politike apo sociale. Vetëm 12% e femrave deklarojnë të kenë kontaktuar me një zyrtar gjatë 12 muajve të fundit për të shprehur opinionin e tyre. Kjo shifër është dy herë më e ulët se ajo e meshkujve që deklarojnë po të njëjtën gjë (25% kanë kontaktuar një zyrtar gjatë 12 muajve të fundit). Akoma më shqetësues është fakti që 41% e femrave deklarojnë se nuk do ta ndërmerrnin kurrë një iniciativë të tillë si të kontaktonin apo vizitonin një zyrtar për të ndarë mendimet dhe shqetësimet e tyre mbi çështjet politike, numër goxha më i madh se numri i meshkujve që kanë deklaruar të njëjtën gjë (25%). Përdorimi i “rrjeteve sociale” (Facebook,

Twitter etj) për të ndarë opinionet mbi çështjet sociale është shumë i ulët (8% e meshkujve dhe 6% e femrave deklarojnë se nuk i kanë përdorur kurrë këto mjete për këtë qëllim). Përdorimi i “peticioneve” (3% meshkuj dhe 2% femra), i “protestave/demonstratave” (10% meshkuj dhe 5% femra) ose i “mediave” (1% meshkuj dhe 2% femra) është gjithashtu shumë i ulët.

- Gjetjet e sondazhit japin një mesazh optimist në lidhje me pjesëmarrjen e grave në procesin e vendimmarrjes. Rreth 93% e të intervistuarve do të mbështesnin pjesëmarrjen e grave në politikë si “kandidate për poste publike”.
- Ndërsa shumica e shqiptarëve do të mbështesnin një pjesëmarrje më të lartë të grave në politikë, ka edhe një pjesë të konsiderueshme të popullsisë, përfshirë femrat, të cilët mendojnë se “meshkujt janë udhëheqës më të mirë politikë sesa gratë”. 58% e meshkujve dhe 38% e femrave të intervistuar bien dakord se “meshkujt janë udhëheqës politik më të mirë se gratë”. Këto gjetje, tregojnë se ndërsa “pjesëmarrje më e lartë në politikë të grave” mund të jetë qëndrimi korrekt politik, ky nuk është një mendim gjerësisht i përhapur dhe i pranuar. Ky mendim më tepër i ngjason “të thënit” se sa “të bërit”.
- Perceptimi i mungesës së aftësisë së grave për të marrë vendime të natyrës politike është më i dukshëm tek të intervistuarit pa arsimin e duhur, apo me një arsim relativisht të ulët.

Votimi Familjar dhe Sjellja e Votuesit

- Në total, ka një nivel të lartë pjesëmarrje të votuesve nga popullata. Rreth 88% e të intervistuarve deklarojnë se kanë votuar në zgjedhjet e 2013, pa ndonjë ndryshim mes gjinive.
- Shumica e të intervistuarve deklarojnë se u ndjenë “plotësisht të lirë” kur marrin vendimin për kë të votojnë në zgjedhjet e 2013 (95%). Nuk u vunë re ndryshime midis të intervistuarve meshkuj dhe atyre femra. Këto gjetje tregojnë se presioni i drejtpërdrejtë

dhe i dhunshëm mbi votuesit për të votuar kundër vullnetit të tyre, nuk ka qënë shumë prezent. Megjithatë, kjo nuk e përjashton mundësinë që votat të jenë premtuar në këmbim të favoreve. Pikërisht, 43% e të intervistuarve deklarojnë se janë në dijeni të rasteve në të cilat votat janë premtuar në këmbim të favoreve. Në veçanti, votimi “ për të mbajtur vendin e punës”, apo për “ tu punësuar pas zgjedhjeve”, si dhe votimi në “këmbim të parave apo dhuratave” përmenden si fenomene të shpeshta nga më shumë se 1/3 e të intervistuarve.

- Votimi Familjar nis në shtëpi dhe shpesh perceptohet si një akt i përfaqësimit të interesave familjare apo të statusit (nëse familja e një gruaje nuk shkon të votojë në ditën e zgjedhjeve, atëherë ka shumë mundësi që as ajo mos ta bëjë një gjë të tillë). Rezultatet e këtij sondazhi tregojnë se fenomeni i votimit familjar është aktualisht prezent në forma më pak të drejtpërdrejta krahasuar me shëmbujt klasik të raportuar në Sondazhin mbi “*Perceptimin Publik të Përfshirjes së Grave dhe Vajzave në Politikë*” (2008), *Monitorimi i Zbatimit të Kuotave Gjinore dhe Pjesëmarrjes së Grave: Zgjedhjet Parlamentare në Shqipëri*, (2009), *Forumi i Vëzhguesve Vendorë për Monitorimin e Pjesëmarrjes së Grave dhe Vajzave në Zgjedhje* (2011). Në shumicën e këtyre rasteve, është raportuar se një anëtar i familjes ka shoqëruar gruan në dhomën e votimit, dhe ka votuar për të. Megjithatë, aktualisht, votimi familjar nis në shtëpi, ku anëtarët e familjes diskutojnë preferencat e tyre politike, dhe në fund gratë i binden presionit nga anëtarët e tjerë të familjes për të votuar për një kandidat apo parti specifike.
- Vetëm 5% e të intervistuarve pretendojnë se Komisionet në Qëndrat e Votimit kanë lejuar më shumë se 1 person në dhomën e votimit në ditën e zgjedhjeve në 2013. Pavarësisht faktit se ky është një “Votim Familjar” jo i drejtpërdrejtë, (për arsye se ka raste që ligji i parashikon kur dikush mund të hyjë i shoqëruar në dhomën e votimit) kjo shifër rezulton të jetë më e ulët se shifrat e raportuara në raporte të ndryshme të monitorimit të

zgjedhjeve të kaluara (2009, 2011, 2013). Raporti i Vëzhguesve Zgjedhor të OSBE/ODIHR-it në 2013, pretendon se “Raste të votimit familjar/në grup u vëzhguan në 13% të QV-të dhe më shpesh në zonat rurale, ndërsa në raportin e 2011 të OSBE/ODIHR-it, kjo shifër ishte “ 26% të QV të vëzhguara”. Megjithatë krahasimi nuk përputhet plotësisht. Shifra e paraqitur nga Studimi Kombëtar i IDRA në 2013 tregon rastet kur qytetarët janë përballur me këtë fenomen gjatë procesit të votimit, ndërsa shifrat e raportuara nga misionet e vëzhguesve janë të bazuara në vëzhgimet në Qëndrat e Votimit.

- Rezultatet e sondazhit tregojnë se ka një numër gjithmonë në rënie të grave që ndihmohen nga dikush në dhomat e fshehta, në forma të cilat shkojnë përtej parashikimeve ligjore të Kodit Zgjedhor në Shqipëri. Në 93% të rasteve gjatë zgjedhjeve parlamentare të 2013, gratë u futën në dhomat e fshehta të pashoqëruara. Vetëm 7% të femrave të intervistuar pretenduan se nuk ishin vetëm në dhomat e votimit. Rezultatet tregojnë për një përmirësim të lehtë të situatës krahasuar më 9% të pjesëmarrësve të cilët pretendonin se “gratë votuan të shoqëruara nga dikush tjetër në dhomën e votimit” (*Monitorimi i Zbatimit të Kuotave Gjinore, ACER & ASET, 2009*).
- Diskutimet me grupet e diskutimit treguan se praktikat e Votimit Familjar vijojnë të jenë një shqetësim në ditën e zgjedhjeve në Shqipëri, dhe se fenomeni vërehet më shumë në zonat rurale/të largëta të vendit. Arsyet pse ky fenomen ende vijon të ekzistojë sipas pjesëmarrësve, ndryshojnë nga niveli i ulët arsimor, varfëria, papunësia dhe paaftësia e grave për të kundërshtuar presionin familjar (për shkak të varësisë financiare dhe mungesës së informacionit), strukturat familjare (kryefamiljari zakonisht merr vendimet për të gjithë familjen). Megjithatë, ekziston një besim i përbashkët midis qytetarëve se fenomeni në vitet e fundit është në rënie. Krahasur me gjetjet nga *Monitorimi i Zbatimit të Kuotave Gjinore dhe Pjesëmarrjes së Grave: Zgjedhjet Parlamentare në Shqipëri*, (2009)”, si dhe

ato nga *"Forumi i Vëzhguesve Vendorë për Monitorimin e Pjesëmarrjes së Grave dhe Vajzave në Zgjedhje"* 2011, sipas të intervistuarve dhe pjesëmarrësve në Fokus Grupe, fenomeni i votimit familjar duket të jetë më pak i përhapur në zgjedhjet e fundit parlamentare të 2013.

- Vetëm 7% e femrave të intervistuar pranojnë se kanë patur presion nga një anëtar mashkull i familjes për të votuar për një kandidat apo parti politike specifike. Megjithatë, edhe pse rezultatet e sondazhit nuk tregojnë një pranim të fenomenit të votimit familjar, shumica e të intervistuarve besojnë se vota e grave në Shqipëri nuk përfaqëson vullnetin e tyre, por vullnetin e meshkujve të familjes. Një numër gjetjesh tregon se dijenia për ekzistencën e fenomenit varet nga dimensionin socio-demografik i personit të intervistuar.
 - o Një ndarje sipas gjinisë tregon se më shumë të intervistuarat femra (60%) pretendojnë se gratë në Shqipëri shpesh janë nën presionin e një anëtari mashkull të familjes për të votuar për një parti apo kandidat specifik (55% e meshkujve besojnë të njëjtën gjë).
 - o Të intervistuarit me arsim më të lartë, apo në përfundim e sipër, janë më në dijeni të faktit se vota e femrave në Shqipëri nuk reflekton gjithmonë vullnetin e tyre. Të intervistuarit pa arsimin e duhur, apo me atë 8-vjeçar, e mohojnë faktin se meshkujt në familje ushtrojnë presion tek gratë për të votuar për një kandidat apo parti specifike.
 - o Të intervistuarit më të moshuar, janë ata të cilët e injorojnë ekzistencën e këtij fenomeni në familje. Ashtu si në vitet e kaluara, grupet që janë më të predispozuar për të pranuar ekzistencën e fenomenit janë meshkujt/femrat nën 30 vjeç. Si rrjedhojë, ky grup ka më pak gjasa të influencohet në votën e tyre nga anëtarët e familjes.

- o Të intervistuarit nga zonat rurale janë ata të cilët e mohojnë më së shumti presionin e ushtruar mbi gratë/vajzat nga anëtarët meshkuj të familjes. Mohimi i ekzistencës së fenomenit duket të jetë më i lartë në rajonet e Lezhës, Kukësit, Durrësit, dhe Shkodrës.

Gratë dhe Vendimmarrja

- Një shumicë e madhe e të intervistuarve mendon se gratë i kanë aftësitë e duhura për të vendosur për çështje politike (87%). Megjithatë, ende 1 në 6 meshkuj besojnë se gratë nuk i kanë këto kapacitete dhe se është mashkulli ai që duhet të marrë vendime për femrat kur vjen puna për çështje politike. 1 në 3 meshkuj dhe 1 në 5 femra nuk mendojnë se "meshkujt dhe gratë kanë të njëjtat aftësi për vendimmarrje".
- Të intervistuarit në zonat rurale janë gjithashtu më të prirur për të menduar se gratë nuk janë të afta të marrin vendime politike dhe se në përgjithësi burrat janë udhëheqës politik më të mirë se gratë.
- Ashtu si rezultatet e 2012 në raportin mbi "Pjesëmarrjen e grave në Shqipëri në Politikë dhe Vendimmarrje", ka një perceptim pozitiv, i cili është në rritje konstante, për femrat e përfshira në politikë dhe vendimmarrje. Shumica e të intervistuarve (81% e femrave) si dhe pjesëmarrësit në Grupet e Diskutimit, vlerësojnë femrat për aftësitë dhe kontributin e tyre në fusha të ndryshme, sidomos në ato të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, arsimin, politikën shëndetësore, dhe çështjet sociale. Përgjithësisht, të intervistuarat femra mbështesin më tepër pjesëmarrjen e grave në politikë, krahasuar me të intervistuarët meshkuj. 95% e të intervistuarave femra do të mbështesnin pjesëmarrjen e grave në politikë, krahasuar me 90% të të intervistuarve meshkuj.
- Të intervistuarit me një nivel më të lartë arsimor mbështesin më tepër pjesëmarrjen e grave në politikë krahasuar me të intervistuarit me një nivel arsimor më të ulët.

- Mbështetja për pjesëmarrjen e grave në politikë është më e ulët tek pjesëmarrësit që jetojnë në zonat rurale.
 - Numri i grave që nuk mbështesin një pjesëmarrje më të madhe të grave/vajzave në politikë është shumë i vogël (5%). Megjithatë, një analizë më e detajuar e këtij kampioni do të nxirrte në pah faktin se gratë me nivel më të ulët arsimor, ato që kanë frekuentuar arsimin profesional, ato aktualisht të papuna, shtëpiaket, si dhe të intervistuarat femra të cilat janë në pension, rezultojnë të jenë më skeptike përsa i përket përfshirjes së grave në politikë
 - Megjithatë, krahasuar me vitet e mëparshme (2010,2012) është vënë re një progres përsa i përket sjelljes kundrejt femrave që kandidojnë për poste të rëndësishme publike. Femrat ndihen të motivuara dhe të bindura se një numër më i madh i femrave në pozicionet vendimmarrëse do të ofronin më shumë zgjidhje për femrat dhe problemet e komunitetit.
- Njohuritë për Kuotat Gjinore dhe Mbështetja**
- Shqiptarët nuk janë të informuar siç duhet mbi qëllimin e kuotave gjinore në politikë, apo se si ato implementohen. Vetëm 1 në 2 të intervistuar e di se është një detyrim për partitë politike të rezervojnë të paktën 30% të listës së kandidatëve për gratë. Të tjerët ose nuk janë në dijeni, ose u referohen gabim kuotave. Ashtu si në raportin mbi *"Gjendjen e Grave Lidere në Nivelin Lokal në Shqipëri"*, 2010, ka një njohuri të përgjithshme mbi ekzistencën e kuotave gjinore, por shumë pak pjesëmarrës mund të ofrojnë detaje mbi këto kuota, dhe se si ato duhet të zbatohen. Ndarja sipas gjinisë, tregon se ka më pak të intervistuarat femra (41%) të cilat janë në dijeni të kuotave gjinore, krahasuar me (53%) të meshkujve të intervistuar. Shqiptarët nuk janë plotësisht të informuar mbi qëllimin e kuotave gjinore në politikë, apo se si ato zbatohen.
 - Akoma më zhgenjyes është fakti se gratë/vajzat janë përgjithësisht më pak të informuara mbi qëllimet specifike të këtyre kuotave. Ndarja sipas gjinisë tregon se ka më pak të intervistuarat femra (41%) të cilat janë në dijeni për përcaktimet e kuotave gjinore , krahasuar me meshkujt (53%).
 - o Të intervistuarit me një nivel arsimor më të lartë, janë përgjithësisht më në dijeni të qëllimit të kuotave gjinore krahasuar me ato më një nivel arsimor më të ulët. (shkolle e mesme/ 8 vjeçare)
 - o Të intervistuarit midis 40-50 vjec, gjithashtu duket se janë më të informuar mbi kuotat gjinore.
 - o Të intervistuarit që jetojnë në zonat urbane janë kryesisht më të informuar mbi kuotat gjinore dhe qëllimet e tyre krahasuar me ata që jetojnë në zonat rurale.
 - Të intervistuarit që janë më të informuar mbi kuotat gjinore mbështesin më tepër zbatimin e tyre krahasuar me ata që nuk kanë informacionin e duhur .
 - Megjithatë, ka një mbështetje përgjithësisht të lartë për përfshirjen e kuotave gjinore në politikë, dhe në institucionet e zgjedhura. Rreth 83% e të intervistuarve do ti mbështesnin këto kuota, 45% do ti "mbështesnin fuqimisht", dhe 38% të cilët do ti "mbështesnin deri diku". Vetëm 9% e të intervistuarve janë kundër këtyre kuotave. Meshkujt janë përgjithësisht më pak mbështetës të kuotave gjinore dhe disa prej tyre mendojnë se kuotat janë instrumente artificiale për të rritur pjesëmarrjen e grave në politike. Përgjithësisht meshkujt e intervistuar besojnë se kuotat shpesh i anashkalojnë kualifikimet dhe aftësitë e femrave.

2. Hyrje

2.1 Objektivat e Studimit

Synimi i përgjithshëm i këtij studimi është të nxjerrë në pah opinioniet e qytetarëve mbi praktikën e ndryshme që mund të ndërhyjnë në lirinë e votimit si dhe të identifikojë mangësitë (ligjore, kulturore, dhe strukturore) që fshihen pas këtyre fenomeneve. Studimi gjithashtu synon të përshkruaj praktikën e “votimit familjar”¹ në Shqipëri duke paraqitur rekomandime mbi mënyrat se si mund të luftohet.

Objektiva të tjera të studimit janë (i) krahasimi i progresit (apo regresit) me raportet e mëparshme të monitorimit nga UN Women dhe (ii) përcaktimi i një baze krahasimi duke përfshirë referencën ligjore të “votimit familjar” dhe praktikave të tjera negative. Me anë të punës kërkimore u bë e mundur një bazë krahasimi me publikimet e mëparshme (2009-2013) dhe statistikat, informacionin apo raportet e tjera të mbështetura nga UN Women mbi *çështjet gjinore të lidhura me lirinë e votimit, votimin familjar dhe praktikave të tjera negative*.

Mbi këtë analizë studimi ofron rekomandime konkrete mbi ndërhyrjet e ardhshme që duhen kryer për të përmirësuar aksesin e drejtë të grave në proceset elektorale dhe parandalimin e praktikave të “votimit familjar” si nga ana institucionale dhe ajo kulturore.

Numri i lartë i rasteve të “votimit familjar” është një tregues i cili përdoret për të vlerësuar përmbushjen e standardeve demokratike në proceset zgjedhore. Për këtë arsye, ky raport përpiqet të japë një panoramë multidimensionale të gjendjes së grave në Shqipëri përsa i përket sjelljes së tyre gjatë votimeve, nivelin e angazhimit të tyre civil në shoqëri, përfshirjen e tyre në procesin e vendimmarrjes në

pozicione të rëndësishme publike si dhe mbështetjen publike për përfshirjen e grave në fusha të ndryshme në Shqipëri.

Rezultatet kryesore dhe rekomandimet e studimit do të kontribuojnë gjithashtu në përcaktimin e çështjeve kryesore që duhen trajtuar nga UN Women, në kuadër të programit të pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje dhe për të kuptuar më mirë perceptimet mbi procesin zgjedhor, nevojat për informacion të votuesve si dhe sjelljen e votuesve në Shqipëri.

2.2 Konteksti i Hulumtimit

Pjesëmarrja dhe Përfaqësimi i Grave në Politikë

Pjesëmarrja e grave në politikë dhe vendimmarrje është një pengesë e vazhdueshme me të cilën Shqipëria është përballur gjatë këtyre viteve të formimit të demokracisë. Pavarësisht perceptimit të një ndjeshmërie në rritje mbi çështjet gjinore, gjendja e grave në Shqipëri ka ende nevojë për përmirësim. Studime dhe raporte të ndryshme tregojnë se pjesëmarrja e grave në politikë dhe vendimmarrje vijon të jetë e kufizuar për arsye të ndryshme, kryesisht të lidhura me stereotipet gjinore mbi aftësinë e gruas për tu përfshirë në këtë fushë².

Përfaqësimi i ulët në institucionet e zgjedhura është një pengesë me të cilën gratë në Shqipëri përballen momentalisht. Kuadri ligjor gjinor i cili u prezantua në 2008 dhe 2009, me qëllimin për të garantuar përfaqësimin e duhur të grave, nuk është zbatuar plotësisht nga institucionet përgjegjëse deri më tani. Si rrjedhojë, ka një përfaqësim të kufizuar të grave si në nivelin lokal, ashtu edhe në nivelin qendror të qeverisë. Bazuar në rezultatet e KQZ-së në

1. Votimi familjar është praktika në të cilën pjesëtarë të një familje hedhin votën në vend të të gjithë familjes ose në rastin kur një pjesëtar i familjes vë nën presion familjarët e tjerë për të votuar një kandidat apo parti të caktuar

2. Shiko “GRATË NË POLITIKË DHE VENDIMMARRJE NË SHQIPËRI: ANALIZË CILËSORE”; Elona Dhembo; “The Journal of International Social Research”, 2010. Shiko gjithashtu studimin mbi: VLERËSIMI I SITUATËS EKONOMIKE TË GRAVE në Tiranë, Vlorë, Shkodër dhe Elbasan; nga Milva Ekonomi, Mirela Arqimandriti; Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim; mbështetur nga UN Women

Zgjedhjet Lokale të 2011, vetëm 3 nga 65 Kryetarët e Bashkive në Shqipëri janë momentalisht femra.³ Në 2011 24.3 % e punonjësve civil si drejtues të lartë dhe 39.2% e punonjësve civil si drejtues të mesëm, ishin femra.⁴

Përfaqësimi i grave në institucionet e zgjedhura ka patur një përmirësim të lehtë pas procesit zgjedhor të Qershorit 2013. Gratë fituan 18.6% të vendeve në zgjedhjet e fundit parlamentare të 2013 në Shqipëri, krahasuar me 16.4% në 2009. Për më tepër, 5 nga 19 e ministrave të kabinetit qeveritar (26%) dhe 8 nga 23 të zv/ministrave në qeverinë aktuale (34%) janë femra. Femra të tjera janë emëruar në krye të departamenteve të tjera të rëndësishme qeveritare si Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Doganat, etj.

Në janar 2014 Shqipëria u rendit në vendin e 74-t (nga 145 shtete) në Renditjen Botërore të UN Women, bazuar në përqindjen e grave në parlamentet me një dhomë apo në dhomat e ulëta. Vendi pati një përmirësim në renditje nga Janari 2011 kur u rendit në pozicionin e 82-të.

Ndërkohë që përfaqësimi politik i grave në institucionet e zgjedhura është ende i ulët, pjesëmarrja e tyre në votime është përgjithësisht e lartë. Të dhënat e mbledhura nga KQZ për herë të parë gjatë zgjedhjeve të 2011 tregojnë se gratë/vajzat përbënin 50.2% të numrit total të votuesve të raportuar nga qendrat e votimit. Nuk ka të dhëna të disponueshme mbi pjesëmarrjen e grave në Zgjedhjet e Përgjithshme të 2013, por përgjithësisht mendohet se niveli i pjesëmarrjes është pothuajse i njëjtë. Ja vlen të theksohet se këto zgjedhje shënuan përqindjen më të lartë të votuesve (53.47%) në kohët demokratike në Shqipëri.

Megjithatë, niveli i lartë i pjesëmarrjes në votime jo domosdoshmërisht do të thotë një nivel të lartë të pjesëmarrjes në

aktivitete politike. Një raport i 2011 nga Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemeve Zgjedhore (AIDEC) theksonte se *“pavarësisht se pjesëmarrja në votime ishte e lartë tek femrat, pjesëmarrja e grave/vajzave në fushatën zgjedhore ishte e ulët”*.⁵ Sipas këtij raporti: *“Në 99 aktivitete zgjedhore të monitoruara në rajone⁶ të ndryshme vetëm 33% të pjesëmarrësve ishin femra”*.

Votimi Familjar: Përkufizimet dhe Gjëndja Aktuale

Disa raporte të monitorimit të zgjedhjeve të cituara në këtë raport, si nga vëzhguesit kombëtarë dhe nga ata ndërkombëtarë, pretendojnë se një nga problemet më të mëdha për pjesëmarrjen e femrave në proceset elektorale në Shqipëri është fenomeni i “votimit familjar”. Sipas këtyre raporteve, gratë në Shqipëri janë ose subjekt i presionit për të votuar për një kandidat të cilin jo domosdoshmërisht e mbështesin, ose janë nën presion për të mos votuar fare.

Bazuar në një raport mbi “Përgjigjen e Konsoliduar për Parandalimin e Votimit Familjar” nga Rrjeti Ndërkombëtar i Informacionit për Gratë në Politikë (2009), “Votimi Familjar” mund të përfshijë raste kur:

- a) Një anëtar mashkull i familjes shoqëron një ose më shumë të afërme femra në dhomat e votimit
- b) Grupe familjare votojnë haptazi bashkarisht
- c) Një anëtar mashkull i familjes tërheq fletë votimi në emër të anëtarëve të familjes dhe i shënon ato ashtu siç dëshiron.

Pavarësisht pengesave që lidhen me përkufizimin e duhur të “Votimit Familjar”, si vëzhguesit lokalë ashtu edhe ata ndërkombëtarë, përgjithësisht bien dakord se cilat pyetje nevojiten të bëhen për të identifikuar rastet e këtij fenomeni. Shumica e studimeve në këtë

3. I aksesueshëm në <http://open.data.al/sq/lajme/lajm/lang/sq/id/407/Raporte-gjinore-ne-listat-e-kryetareve-te-bashkive--2000---2015->

4. Idem

5. GRATË DHE VAJZAT NË ZGJEDHJET LOKALE”, Maj, 2011; Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemeve Zgjedhore (AIDEC) & Klea Faniko; (Mbështetur nga UN Women)

6. Raporti monitoroi rajonet e Gjirokastrës, Vlorës, Korçës, Tiranës, Shkodrës and Kukësit.

fushë fokusohen tek fakti nëse gratë shoqërohen në dhomat e votimit nga anëtarë të tjerë të familjes në Ditën e Zgjedhjeve.

Ashtu siç përmendet më sipër, disa raporte të monitorimit të zgjedhjeve tregojnë se ka një numër të madh të grave të cilat asistohen në dhomat e votimit në ditën e zgjedhjeve në Shqipëri në forma të cilat shkojnë përtej parashikimeve të ligjit⁷.

Më saktësisht, në raportin e Misionit të Vëzhguesve Zgjedhorë të OSBE (2009) thuhet se *“ndikimi tek vullneti i gruas/vajzës për të votuar një kandidat/parti të votuar nga bashkëshorti/ babai është një fenomen i përsëritur në praktikat zgjedhore shqiptare”*. *“Shqetësimi”* i treguar nga bashkëshorti/ babai që gruaja/vajza të mos *“gabojë”* apo tendenca për të dhënë *“udhëzime”* për gruan/vajzën kur ajo futet ose kur është në dhomën e votimit me synimin që vota *“të mos bëhet e pavlefshme”*, janë vetëm disa nga manifestimet e fenomenit të *“votimit familjar”*.⁸

Raporti Final i Monitorimit të Zgjedhjeve Parlamentare të 28 Qershorit 2009, nga Misioni i Vëzhguesve Ndërkombëtarë të OSBE/ODIHR-it i referohej fenomenit të *“votimit familjar”* si një problem serioz dhe pretendonte se *“një shkelje e fshehtësisë së votës u raportua në 19% të qëndrave të votimit të vizituara”*. (OSBE & ODIHR, 2009, f.24)

Në 2011, në Raportin Final, OSBE & ODIHR-i përsëri deklaroi se *“Aftësia e shumë grave për të ushtruar të drejtën e tyre për të votuar të lira u ndikua nga rastet e shpeshta të votimit familjar dhe të votimit në emër të dikujt tjetër, të cilat u vunë re në 26% të QV të vizituara”* (OSBE & ODIHR, 2011, fq. 22).

Edhe së fundmi Raporti i Vëzhgimit të Zgjedhjeve të Përgjithshme të 2013 nga OSBE pretendonte se *“Raste të votimit familjar/në grup u vëzhguan në 13 përqind të QV-ve dhe më shpesh në zonat rurale”* (OSBE & ODIHR, 2013, fq.23).

Studime mbi fenomenin e *“votimit familjar”* gjatë proceseve zgjedhore në Shqipëri janë kryer edhe nga vëzhgues vendorë. Në 2008, një sondazh mbi *“Perceptimin Publik të Pjesëmarrjes së Grave në Zgjedhje në Shqipëri”* raportonte për *“një numër të lartë femrash që asistohen në dhomat e votimit në forma të cilat nuk parashikohen nga ligji”* (ACER, ASET, UNDP, 2008). Sipas këtij raporti, ka shumë mundësi që *“votimi familjar”* ka qënë arsyeja pas rritjes së numrit të femrave që asistoheshin tek kutitë e votimit.

Në 2009 një raport mbi *“Monitorimin e Zbatimit të Kuotave Gjinore dhe Pjesëmarrjen e Grave”* i përgatitur nga vëzhgues vendorë e konsideronte *“votimin familjar”* si një problem gjatë procesit zgjedhor. Megjithatë, në atë kohë raporti vërente një *“rënie të lehtë në numrin e rasteve të votimit familjar krahasuar me zgjedhjet e mëparshme”* (ACER & ASET, UNDP, 2009) Studimi gjithashtu theksonte faktin se midis 4 rajoneve⁹ të cilat u vëzhguan gjatë ditës së zgjedhjeve, rastet e *“votimit familjar”* u raportuan më shpesh në zonat veriore të vendit. Në mënyrë të ngjashme, një studim kombëtar mbi *“Situatën e Grave Lidere në Nivelin Lokal”* në Shqipëri i publikuar në 2010 pretendonte se *“diskriminimi aktiv kundër grave që marrin pjesë lirisht në zgjedhje praktikohet në formën e votimit familjar”* (ACER, ASET, 2010). Në raport thuhet gjithashtu se fenomeni ishte *“veçanërisht problematik në zonat rurale”*.

Votimi Familjar: Korniza Ligjore Ndërkombëtare

Sipas standardeve ndërkombëtare praktikat e votimit familjar, në të cilin një anëtar i familjes (zakonisht mashkull) voton në emër të të gjithë familjes apo kur gruaja dhe burri hyjnë së bashku në dhomën e votimit, nuk është një praktikë e pranueshme në zgjedhje demokratike.¹⁰

7. Neni 108” i Kodit Zgjedhor Shqiptar

8. Raporti Final i Misionit të Vëzhguesve Zgjedhor të OSBE/ODIHR-it, Shqipëri 2009: <http://www.osce.org/sq/odihr/elections/albania/38598>

9. Rajonet e monitoruara në 2009: Kukës, Elbasan, Gjirokastër, Vlorë

10. Gratë & Zgjedhjet: Guida për promovimin e pjesëmarrjes së grave në zgjedhje. Shiko: (<http://www.un.org/womenwatch/osagi/wps/publication/Chapter5.htm>)

Bazuar në këto standarte votimi familjar, jo vetëm cënon të drejtën e grave për të shprehur lirisht opinionin e tyre, por gjithashtu parimin e fshehtësisë së votës, i cili është një nga të drejtat themelore politike i mbrojtur nga një numër i madh dokumentash ligjore ndërkombëtare. Neni 21, Paragrafi 3, i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut përcakton se: *"Vullneti i popullit do të jetë baza për autoritetin e qeverisë; ky vullnet, do të shprehet në zgjedhje periodike dhe të vërteta, të cilat do të jenë universale, dhe me pjesëmarrje të barabartë dhe do të mbahet me votë të fshehtë apo me procedurë të barazvlefshme votimit."*

Në mënyrë të ngjashme, dokumenta të tjera ligjore ndërkombëtare si Konventa mbi të Drejtat Civile dhe Politike (Neni 25, Paragrafi 2), Konventa e Eliminimit të të gjitha formave të Diskriminimit kundër Grave, "Dokumenti i Kopenhagenit" i OSBE-së dhe Protokollit i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut thekson rëndësinë e të drejtës së individit për të votuar lirshëm dhe në fshehtësi. Shqipëria merr pjesë dhe zbaton përcaktimet e këtyre dokumentave.

Për më tepër, barazia gjinore është në të njëjtën kohë një detyrim i cili rrjedh nga Marrëveshja e Stabilizim Asocimit me BE, e firmosur nga Shqipëria në 2006. Marrëveshja kërkon një përshtatje të kornizës ligjore të Shqipërisë me *acquis communautaire*. Si rrjedhojë, procesi i integritimit Europian kërkon një përshtatje të ligjeve shqiptare mbi çështjet gjinore me praktikën më të mira Europiane.

Votimi Familjar dhe Përfaqësimi i Grave: Korniza Ligjore Kombëtare

Në 2008, në Shqipëri u prezantuan ndryshime të rëndësishme legislative me synimin për të inkurajuar barazinë gjinore në institucionet e zgjedhura. Një nga ndryshimet ishte adoptimi i kuotave gjinore në pozicionet e zgjedhura dhe të emëruara në Ligjin mbi "Barazinë Gjinore në Shoqëri" (Korrik 2008).

Ligji parashikonte një përfaqësim prej të paktën 30% për çdo gjini në të gjitha institucionet e zgjedhura dhe ato publike.

Amendime të tjera u paraqitën për Kodin Zgjedhor Shqiptar, me përfshirjen e përcaktimeve ligjore sipas së cilave *"Për çdo zonë elektorale, të paktën 30% e listës shumëemërore dhe 1 nga 3 emrat e listës shumëemërore duhet ti përkasin çdo gjinie"*. Amendimet përfshijnë gjithashtu penalitete dhe gjopa për subjekte të cilat nuk i përmbushin kriteret.

Në 2012 Kodi Zgjedhor Shqiptar u amendua sërish, kur penalitete dhe gjopa më të ashpra u përfshinë për ato subjekte politike, lista e kandidatëve e të cilave nuk i përmbushin kriteret gjinore. Si rrjedhojë, për partitë politike, lista e të cilave nuk i përmbush përcaktimet gjinore të Kodit Zgjedhor u përfshinë gjopa prej *"1 milion lekësh për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe 50 000 lekësh për Zgjedhjet Lokale."*

Ndryshimet e tjera të përfshira në Kodin Zgjedhor në 2012 u fokusuan në zëvendësimin e mandatit të deputetëve kur ai/ajo vendos të heqë dorë nga ky i fundit, apo kur mandati ndërpritet bazuar në përcaktimet e Nenit 71 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Sipas ndryshimeve të paraqitura,¹² *"kur vakanca i përket një mandati të fituar sipas pikës 6 të nenit 67, ajo plotësohet nga kandidati i parë në listë i gjinisë përkatëse, pavarësisht renditjes në listë."*

Ndryshimet që janë përfshirë si në Ligjin mbi Barazinë Gjinore në Shqipëri në 2009 ashtu edhe në Kodin Zgjedhor që prej 2008, kanë krijuar një konteskt të favorshëm për rritjen e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave shqiptare në politikë në rang kombëtar. Për shëmbull, në zgjedhjet e përgjithshme të Korrikut 2009 numri i grave anëtare të parlamentit më shumë se u dyfishua, nga 7% në 2006, në 16.4 % (ACER & ASET, 2010).

11. Ligji Nr. 74/2012, data 19.07.2012 " Për disa shtesa dhe amendime mbi Ligjin Nr.10019 data 29.12.2008; "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"

12. Neni 164/2: I amenduar nga Ligji Zgjedhor Nr.74/2012

Perfshirja e penaliteteve ligjore dhe amendimeve në kornizen ligjore shqiptare ka patur gjithashtu një efekt pozitiv në reduktimin e numrit të rasteve të “votimit familjar” në ditën e votimit. Legjislacioni kombëtar e konsideron “votimin familjar” si një cënim thelbësor të të drejtave të individit, bazuar në Nenin 45/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në bazë të këtij neni, vota e çdo qytetari duhet të jetë e “lirë, e fshehtë dhe individuale”.

Legjislacioni kombëtar e konsideron “votimin familjar” si një cënim thelbësor të të drejtave të individit, bazuar në Nenin 45/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në bazë të këtij neni, vota e çdo qytetari duhet të jetë e “lirë, e fshehtë dhe individuale”.

Me synimin për të garantuar këtë të drejtë kushtetuese institucionet e administrimit zgjedhor mbështeten edhe në penalitetet ligjore si për ata të cilët përfshihen në këto praktika, ashtu edhe për ata të cilët i lejojnë ato në ditën e votimit. Penalitetet ligjore të përfshira në Nenin 106.5 të Kodit Zgjedhor përcaktojnë së “Anëtarët e komisioneve të QV, të cilët kanë lejuar një votues të votojë më shumë se 1 herë ose në emër të dikujt tjetër” janë subjekt i ndëshkimit penal në bazë të Nenit 248 të Kodit Penal¹³. Ndëshkimi për këto veprime, sipas nenit të mësipërm, është “heqje lirie nga 6 muaj deri në 5 vjet dhe gjobë nga 300.000 lekë deri në 1.000.000 lekë.”

Sipas Ligjit Nr. 9970 (datë 24.07.2008), “Mbi Barazinë Gjinore në Shoqëri” (LBGJ12), Neni 15: Mbi pjesëmarrjen në procesin e vendim-marrjes::

1. Përfaqësimi i barabartë gjinor të gjitha organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe në institucionet e tjera publike arrihet kur::
 - a) sigurohet përfaqësim në masën mbi 30 për qind për secilën gjini, përfshirë edhe në organet e tyre drejtuese;
 - b) sigurohet respektimi në mënyrë të njëjtë për secilën gjini i procedurave dhe kriterëve të konkurimit, gjatë emërimit në këto organe;
 - c) sigurohet përfshirja mbi 30 për qind e secilës gjini në listën e kandidatëve për zgjedhjet në organet përfaqësuese vendore;
 - ç) sigurohet përfshirja jo më pak se 30 për qind e secilës gjini në listën e kandidatëve të paraqitur nga partitë politike për sistemin proporcional për zgjedhjet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;
 - d) sigurohet përfshirja mbi 30 për qind e secilës gjini në organet administruese të procesit të zgjedhjeve qendrore dhe vendore.
2. Partitë politike përcaktojnë mënyrat dhe masat për të përmbushur kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.
3. Partitë politike paguajnë një gjobë deri në një të dhjetën e fondit shtetëror për financimin e fushatës zgjedhore, nëse shkelin dispozitat e këtij neni, deri në ndreqjen e shkeljes.

2.3 Metodologjia


Nga pikëpamja metodologjike ky studim kaloi nëpër disa faza të implementimit:

1. **Proçesi i Hulumtimit** – Proçesi nisi me një bazë të dhënash të mbledhura nga publikime të ndryshme nga UN Women si dhe raporte të tjera të vlefshme, të cilat ofruan informacion dhe statistika krahasimore për lirinë e të votuarit, “votimin familjar” dhe praktika të tjera negative të votimit në Shqipëri.
2. **Hulumtimi Sasior** – U përgatit një sondazh kombëtar me popullsinë mbi 18 vjeç. Në total u plotësuan 2200 pyetesorë (nga të cilët 200 për komunitetin Rom & Egjiptian)
3. **Hulumtimi Cilësor** – U organizuan 6 grupe diskutimi duke ndjekur një guidë moderimi me qëllimin për të zbuluar aspekte të tjera shtesë nga çështjet që trajtohen në pyetesor.

Sondazh sasior


Kampioni i Përgjithshëm Publik

Sondazhi i përgjithshëm publik u bazua në disa faza. Probabiliteti rastësor u nxorr nga një listë qendrash votimi të zgjedhjeve të fundit të përgjithshme në 2013. Për qëllime kampionimi, Qendrat e Votimit shërbejnë si Njësi Primare Kampionimi. 196 Njësi Primare të Kampionimit u zgjedhën duke përdorur një formulë e cila gjeneron numra në mënyrë të rastësishme duke marrë parasysh numrin e votuesve për çdo qendër votimi si dhe dimensionin urban kundrejt atij rural. Brenda zonës gjeografike të përcaktuar nga këto njësi të intervistuarit u zgjedhën në bazë të një metode rastësore



(u zgjedh çdo derë e tretë në të djathtë dhe personi mbi 18 vjeç me ditëlindjen e fundit në atë shtëpi u intervistua).

Shpërndarja Gjeografike e Kampionit



Madhësia e kampionit

N=2000 të intervistuar

Koha e hulumtimit


Nëntor - Dhjetor 2013

Metodologjia

Intervistë ballë për ballë

Kampioni Shtesë i Romëve

U përzgjedh një kampion shtesë prej N=200 persona vetëm për komunitetin Rom. Kampioni u përzgjedh nga hartat e vendbanimeve të komunitetit Rom të krijuara nga sondazhet e mëparshme të IDRA-s mbi këtë temë. Nga këto harta u përcaktuan dhe më pas u përzgjedhën Njësitë Primare të Kampionimit. Metoda e përzgjedhjes së familjes dhe të intervistuarëve është e njëjtë me atë të sondazhit Publik të Përgjithshëm (rregull i krahut të djathtë, çdo derë e tretë, të intervistuarit me ditëlindjen e fundit).



Komponenti Cilësor

Një komponent cilësor i studimit u hartua në mënyrë që të eksplorohejshin në detaje arsyet e “votimit familjar” dhe perceptimet mbi lirinë e votimit. Informacioni cilësor plotëson informacionin sasior të marrë nga studimi kombëtar. Në mënyrë që të merreshin parasysh të gjitha nuancat që rrjedhin nga mosha, statusi social apo vendodhja gjeografike e pjesëmarrësve, një shpërndarje e kujdesshme u përgatit në bazë të përcaktimeve të mësipërme.

Tabela e mëposhtme paraqet këtë ndarje:

Përbërja dhe shpërndarja e Grupeve të Diskutimit

Nr.	Mosha	Gjinia	U/R	Qyteti
1	18-65	F	Urban	Tirana
2	18-65	F	Rural	Tirana
3	18-65	F	Urban	Korca
4	18-65	F	Rural	Korca
5	18-65	F	Urban	Fier
6	18-65	F	Rural	Fier

Grupi i diskutimit në Korçë



Marzhi i Gabimit

Marzhi i gabimit për Kampionin e Popullatës së Përgjithshme është +2.2% me një interval tolerance prej 95%. Teknikisht, një marzh gabimi prej +2.2% do të thotë se nëse kampione të këtyre përmasave do të përsëriteshin, 95% e tyre do të reflektonin pikëpamjet e popullatës me një pasaktësi jo më tepër se +2.2%. Testimi i vlerës statistikore e cila merr parasysh marzhin e gabimit është veçanërisht e rëndësishme kur prezantohen analiza të grupeve të ndryshme të rezultateve. Këto teste statistikore janë aplikuar tek rezultatet e prezantuara përgjatë këtij raporti.

Marzhi i gabimit për kampionin shtesë të komunitetin Rom është $\pm 6.9\%$. Ky marzh gabimi është marrë parasysh kur është bërë krahasimi i kampionit Rom dhe atij të Popullatës së Përgjithshme.

Grupi i diskutimit në Tiranë



3. Gjetjet Kryesore

3.1 Interesi mbi Politikën dhe Angazhimet Civile

Interesi mbi politikën është shumë i ulët për pjesën më të madhe të popullsisë, për më tepër te femrat. Sa më i ri të jetë personi, aq dhe më i ulët është interesi mbi politikën dhe qeverinë. Edhe niveli i angazhimit civil në organizata të ndryshme politike dhe shoqërore në tërësi, sipas deklaratave të të intervistuarve, është gjithashtu i dobët.

Pothuajse 1 në 3 të intervistuar “nuk është aspak i interesuar” në çështjet politike të qeverisë (Fig.1). 18% pohojnë se janë “jo shumë të interesuar” ndërkohë që 30% janë “deri diku të interesuar”. Vetëm 18% e të intervistuarve deklarojnë që janë “shumë të interesuar” për politikën.

Ndarja gjinore tregon qartësisht se mungesa e interesit për politikën është më e lartë midis femrave (38% e femrave të intervistuar kundrejt 29% të meshkujve që deklarojnë mungesë interesi në tërësi). Gjithashtu 29% e meshkujve të intervistuar deklarojnë se janë “shumë të interesuar” në çështjet e politikës dhe qeverisë, krahasuar me vetëm 12% të femrave që deklarojnë të njëjtën gjë.

Bazuar në Grupet e Diskutimit, shumica e femrave refuzojnë të përdorin angazhimin politik si instrument për të përmirësuar situatën e tyre socio-ekonomike për arsye të frikës së humbjes së vendit të punës, të mungesës së vetëvlerësimit si dhe mungesës së besimit tek politika në përgjithësi.

Duke marrë parasysh ndarjen sipas moshës, vihet re qartësisht se sa më i ri të jetë personi i intervistuar, aq më pak i interesuar është mbi politikën. Vetëm 10% e të intervistuarve midis moshave 18-24 vjeç figurojnë “shumë të interesuar” mbi këto çështje, ndërsa ky numër shkon deri në 31% për të intervistuarit e moshave 65 vjeç e sipër (Fig.2).

Grupet e Diskutimit:

“Politika jonë është shumë e keqe. Pavarësisht idealeve dhe përgjegjësisë për të votuar njerëzit janë të lodhur e shumë të pakënaqur nga çdo gjë që po ndodh. Këtë përshtypje kam”. (Femër, Tiranë, Qytet)

“Meshkujt janë më të interesuar për politikën se femrat. Vetëm femrat në punë janë të interesuara për politikën, dhe ato nga halli se mos i heqin nga puna.” (Femër, Fier, Qytet)

Fig. 1 Sa i interesuar jeni për çështjet e politikës dhe qeverisë?

Total & Ndarja Gjinore





Fig. 2 Sa i interesuar jeni për çështjet e politikës dhe qeverisë?

Ndarja sipas moshës



Angazhimi civil, i matur me anë të anëtarësimit të deklaruar të intervistuarve në organizata politike dhe sociale, është i dobët në tërësi. Vetëm 1 në 10 të intervistuar deklaroi se është aktualisht anëtar i një partie, 1 në 30 të intervistuar deklarohet si pjesëtar i ndonjë ndonjë organizate fetare dhe një numër i papërfillshëm figuron si pjesëtar i ndonjë organizate të shoqërisë civile/OJQ-je.

Përfshirja e femrave në këto organizata është edhe më e ulët. Pothuajse 9 në 10 femra, në krahasim me 7 në 10 meshkuj, deklarojnë se nuk kanë qënë kurrë pjesë e ndonjë partie politike. 93% e këtyre femrave nuk kanë marrë kurrë pjesë në ndonjë organizatë për gratë dhe 95% nuk kanë qënë kurrë pjesë e ndonjë OJQ-je ose grupi të organizuar në komunitet.

Grupet e diskutimit nxorën në pah se arsyeja kryesore për një angazhim kaq të ulët është zhgënjimi i përgjithshëm me politikën si dhe një bindje e rrënjësore që zërat e tyre nuk do të dëgjohen ndonjëherë në këto organizata politike. Ekziston një ndjesi e veçantë tek pjesëmarrësit se për të qënë pjesë e partive politike, atyre do t'ju duhet të sakrifikojnë parimet dhe vlerat e tyre morale. Një tjetër arsye, veçanërisht e pranishme tek femrat e punësuar në sektorin publik, është frika e humbjes së vendit të punës nëse bëhen pjesë e partive politike.

Organizatat jo qeveritare vuajnë gjithashtu nga mungesa e besimit në publik. Ka një perceptim të përhapur tek pjesëmarrësit se OJQ-të janë nën ndikimin e partive politike dhe kjo influencë reflektohet në punën që ato bëjnë. Fushatat e ndërmarra prej tyre dhe rezultatet nuk janë shumë të dukshme për të intervistuarit, duke ngritur dyshime se ato i marrin fondet nga donatorët për punë fiktive.

Grupet e Diskutimit:

"Te meresh me politikë? E kam menduar, po punë 4 vjetësh është. Mbas zgjidhjeve gjërat zakonisht ndryshojnë dhe ti mbetesh sërish pa punë. Ketë i them dhe fëmijëve, mos e hapni shumë gojën për politikë. Skam qef të ndaj parimet e mia politike se asnjëherë nuk i dihet. Po jetojmë në kohë të vështira. E kam menduar ti futem politikës po jeta nuk është 4 vjet, jeta është një jetë!" (Femër, Tiranë, Qytet)

"Kemi dëgjuar për to (OJQ)... nuk janë as transparente, as eficiente." (Femër Fier, Urban)

Tab.1 A jeni, apo keni qënë anëtar i ndonjë lloj organizate të listuar më poshtë?

Gjithë Kampioni	Aktualisht Anëtar	Kam qënë anëtar	Nuk kam qënë asnjëherë	Nuk e di/ Refuzoj
Parti Politke	10.8%	8.5%	78.4%	2.4%
Grupe Fetare	3.0%	1.9%	92.3%	2.9%
Organizatë Bamirësie	0.5%	1.2%	95.4%	3.0%
Organizatë Grash	0.5%	2.4%	93.7%	3.5%
OJF	0.4%	1.3%	95.2%	3.2%

Tab.2 A jeni, apo keni qënë anëtar i ndonjë lloj organizate të listuar më poshtë?

Ndarja sipas Gjinisë	Aktualisht Anëtar		Asnjëherë anëtar	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
Parti Politke	16.2%	5.8%	69.7%	86.4%
Grupe Fetare	3.5%	2.4%	91.9%	92.6%
Organizatë Bamirësie	0.4%	0.6%	95.3%	95.5%
Organizatë Grash	0.0%	0.9%	94.9%	92.6%
OJF	0.4%	0.3%	94.9%	95.4%

Femrat tregojnë një nivel të ulët të aktivizimit civil edhe përsa i përket përdorimit të instrumentave/metodave të ndryshme për të shprehur opinionet e tyre për çështje politike apo sociale. Vetëm 12% e femrave deklarojnë të kenë kontaktuar me një zyrtar gjatë 12 muajve të fundit për të shprehur opinionin e tyre (Fig. 4). Kjo shifër është dy herë më e ulët se ajo e meshkujve që deklarojnë po të njëjtën gjë (25% kanë kontaktuar një zyrtar gjatë 12 muajve të fundit) (Fig. 3 & 4).

Akoma më shqetësues është fakti që 41% e femrave deklarojnë se nuk do ta merrnin kurrë një iniciativë të tillë si kontakti apo vizita tek një zyrtar për të ndarë mendimet dhe shqetësimet e tyre mbi çështjet politike, numër shumë më i madh se numri i meshkujve që kanë deklaruar të njëjtën gjë (25%).

Pjesëmarrësit në Grupet e diskutimit shfaqin një sjellje mosbesuese drejt zyrtarëve publik në përgjithësi. Shprehja e pikëpamjeve mbi çështjet politike dhe sociale mund të ndikojë negativisht në mundësinë për të marrë një përgjigje ose zgjidhje nga zyrtari për ndonjë problem të mundshëm personal apo të komunitetit. Nga ana tjetër,

Grupet e Diskutimit:

“Të duash ta takosh një deputet tani mbas zgjedhjeve, nuk e bën dot. Mund të gjejmë kryetarin e partisë, po deputetet sja kemi idenë ku ti gjejmë.” (Femer, Fier, Rurale)

“Njohim deputetet, po nuk dimë ndonjë zyrë. Vetëm gjate zgjedhjeve i shohim këto zyrat” (Korca, Urbane)

pjesëmarrësit deklarojnë se është shumë e vështirë të kontaktosh me parlamentarët, që në parim duhet të jenë “më të aksesueshëm” për të marë opinionet e votuesve. Kjo është veçanërisht e vërtetë për pjesëmarrësit e zonave rurale. Si fillim, njerëzit nuk e dinë se kush do të jetë “përfaqësuesi i tyre në parlament” duke marrë parasysh sistemin aktual të listave për çdo zonë gjeografike dhe së dyti prezenca e parlamentarëve në terren në po këto zona (nga te cilat marrin votat) për kontakt direkt është minimale.

Përdorimi i “rrjeteve sociale” (Facebook, Twitter etj) për të ndarë opinionet mbi çështjet sociale është shumë i ulët (8% e meshkujve dhe 6% e femrave deklarojnë se nuk i kanë përdorur kurrë këto mjete për këtë qëllim). Përdorimi i “peticioneve” (3% meshkuj dhe 2% femra), i “protestave/demonstratave” (10% meshkuj dhe 5% femra) ose i “medias” (1% meshkuj dhe 2% femra) është gjithashtu shumë i ulët.

Fig. 3 A keni bërë ndonjë nga aktivitetet e mëposhtme për të shprehur opinion tuaj mbi çështjet politike ose sociale?

Meshkuj





Fig. 4 A keni bërë ndonjë nga aktivitetet e mëposhtme për të shprehur opinion tuaj mbi çështjet politike ose sociale?

Femra



3.2 VOTIMI FAMILJAR DHE SJELLJA E VOTUESVE

Tradicionalisht, familjet shqiptare u drejtohen Qendrave të Votimit së bashku. Megjithatë, “votimit vamiljar” nuk ndodh në Qendrat e Votimit. Presioni për të votuar një kandidat apo parti të caktuar mund të ndodhë në familje, përpara se të hidhet vota.

Sipas shifrave të KQZ-së zgjedhjet e përgjithshme të 2013 regjistruan zyrtarisht numrin më të madh të votuesve në historinë e zgjedhjeve shqiptare, 53.47%. Një numër kaq i lartë votuesisht u confirmua nga rezultatet e sondazhit. Rreth 88% e të intervistuarve kishin votuar në 2013 (Fig. 5). Midis atyre që nuk kishin votuar (12%), rreth gjysma nuk e kishin bërë sepse realisht nuk kishin mundur (jashtë vendit, nuk mund të votonin për shkak të moshës, sëmundje, etj) dhe jo sepse nuk kishin dashur të votonin. Nuk ka ndryshime me bazë gjinore në këtë aspekt.

Të pyetur nëse u ndjenë të lirë kur morrën vendimin për të votuar, shumica e të intervistuarve deklarojnë se u ndjenë “plotësisht të lirë” (95%). Nuk vihen re dallime domethënëse ndërmjet meshkujve dhe femrave përsa i përket këtij mendimi. Një rezultat i tillë tregon se presioni i drejtpërdrejtë dhe i dukshëm mbi vullnetin e votuesit mund të mos ketë qënë shumë i pranishëm. Megjithatë,

Grupet e Diskutimit:

Unë mendoj se familja ka interes të përbashkët, dhe nëse kanë interesa të përbashkëta, vota do shkojë tek e njëjta parti apo kandidat. Nuk mendoj se duhet të ketë ndryshime të mëdha brënda çiftit për sa kohë kanë të njëjtat interesa. S’e mendoj dot ndryshe. Në familjen time kështu funksionojnë këto gjëra. (Tiranë, Rural)

kjo nuk do të thotë që votat nuk janë premtuar në këmbim të favoreve të ndryshme. Në fakt, rezultatet e pyetjeve të tjera në sondazh që do të prezantohen më vonë në këtë studim sugjerojnë që një fenomen i tillë i votave të premtuara në këmbim të favoreve është mjaft i shpeshtë.

Shumë nga pjesëmarrësit në Grupet e Diskutimit gjithashtu deklarojnë se u ndjenë të lirë për të votuar cilindo që dëshironin pa ndërje asnjë lloj presioni. Megjithëse ata thonë se ka raste kur mbi gratë ushtrohet presion në mënyra të ndryshme nga anëtarët meshkuj të familjes, është një parakusht që femrat duhet të kenë një opinion politik të ndryshëm nga burri në mënyrë që ta ndjejnë presionin. Por sipas femrave, ato zakonisht ose kanë të njëjtin opinion politik si anëtarët meshkuj të familjes, ose nuk kanë asnjë opinion politik. Në këtë mënyrë ato bëhen më lehtësisht subjekte që mund të binden pa ndërje asnjë lloj “presioni”.

Fig. 5 A votuat në Zgjedhjet e Përgjithshme të 2013?

Në total & Ndarja Sipas Gjinisë





Fig.6 Kur morët vendimin për kë do të votonit në zgjedhjet e Qershorit të 2013, a mund të thoni se ju është kërkuar të votonit në një mënyre të caktuar, apo u ndjetë terësisht të lirë për të votuar për cilindo që dëshironit?

Total & Ndarja sipas gjinisë



Ka një lloj konfuzioni midis pjesëmarrësve mbi kuptimin e votimit mbi kuptimin e termit “votim familjar”. Nga diskutimet në Fokus Grupe ka tre kuptime të termit

- Votimi familjar është një fenomen negative në të cilin një person (kryesisht kryefamiljari) voton për të gjithë familjen ose urdhëron/detyron familjen e tij të votojë për një preferencë të caktuar politike;
- Votimi familjar ndodh kur familja diskuton dhe vendos të votojnë një kandidat apo parti specifike, (shpesh bazuar në besimin se kjo do të çojë në një përmirësim financiar dhe social për familjen). Në qendrat e votimit nuk ndodh asnjë gjë.
- Votimi familjar ndodh kur e gjithë familja shkon në Qendrën e Votimit bashkë, por secili voton vetë.

Vetëm kuptimi i parë i termit është në të vërtetë i saktë. Bazuar në këtë “përkufizim”, sondazhi u mundua të krijonte një indikator të jo të drejtpërdrejtë të “Votimit Familjar” duke i pyetur të intervistuarit nëse kishin vënë re raste në të cilat Komisioni i Votimit kishte lejuar më shumë se person në dhomat e votimit.

Vetëm 5% e të intervistuarve thanë se komisionet në QV kanë lejuar më shumë se një person në dhomën e votimit gjatë zgjedhjeve të 2013 (Fig.7). 91% thanë se këto praktika nuk u lejuan ndërsa 4% e të intervistuarve thanë se nuk e mbanin mend. Duhet përmendur se “personi shoqëruar” në dhomat e fshehta mund të ketë qënë atje për arsye të cilat parashikohen në ligj. Shifrat tregojnë se fenomeni i “Votimit Familjar” përmes metodave të tilla të drejtpërdrejta si “shoqërimi i personave në dhomat e votimit dhe votimi në vend të tyre” ndodh rrallë. Pjesëmarrësit në Grupet e Diskutimit gjithashtu konfirmuan se në përgjithësi, njerëzit nuk u lejuan të hynin bashkë në dhomat e votimit.

Rreth 7% e të intervistuarave femra thanë se u shoqëruan nga një anëtar i familjes në dhomën e votimit gjatë zgjedhjeve të fundit (Fig 8). Ndërsa kjo mund të mos duket si një shifër e lartë, është gjithsesi një tregues se një fenomen i tillë ekziston. Në 82% të rasteve në të cilat gratë janë shoqëruar, shoqëruesi ishte një anëtar mashkull i familjes (Bashkëshorti ose Babai). Kur krahasojme rezultatet e pyetjeve të sondazheve të tjera mbi “metodat e votimit familjar”, është e qartë se “votimi familjar”, jo domosdoshmërisht duhet të jetë “hyrja në dhomën e votimit i shoqëruar nga një person mashkull”. Është një fenomen që ndodh gjatë diskutimeve me familjen përpara se familjet të shkojnë për të votuar.

Fig. 7 A lejoj komisioni në qendrën tuaj të votimit (QV) më shumë se 1 person në dhomën e votimit gjatë zgjedhjeve të 2013?

Total & Ndarja sipas gjinisë





Fig. 8 A ju shoqëroi ndonjë anëtar i familjes në dhomën e votimit në këto zgjedhje?

Femra



Në fakt, kur janë pyetur për opinionin e tyre mbi faktin se sa shpesh gratë në Shqipëri janë subjekt i presionit nga anëtarët meshkuj të familjes për të votuar një parti apo kandidat të caktuar, rreth 27% e të intervistuarve deklarojnë se kjo ndodh "Shpesh" dhe "Shumë shpesh". 31% pohojnë se kjo ndodh "Ndonjëherë". Mendimi i femrave të intervistuar në këtë rast është edhe më problematik. Rreth 1 në 3 femra të intervistuar (32%) pohon se ky presion ndodh "Shpesh" ose "Shumë shpesh".

Rezidentët urban janë më në dijeni të fenomenit të "presionit" kundrejt grave nga anëtarët meshkuj të familjes (30% thonë "Shpesh" ose "Shumë shpesh" kundrejt 24% të intervistuarve nga zonat rurale që thonë të njëjtën gjë).

Pjesëmarrësit në Grupet e Diskutimit deklarojnë se kanë dëgjuar ose parë raste konkrete në të cilat femrat janë ndjerë nën presion për të votuar në një mënyrë të caktuar. Ata/ato besojnë se zakonisht femrat, sidomos ata që jetojnë në zonat rurale, do të dorëzohen përballë presionit nga anëtarët meshkuj për të votuar për një parti politike apo kandidat të caktuar.

Sipas rezultateve të studimit sasior dhe Grupeve të Diskutimit, ka një vetëdije të lartë që fenomeni në të cilin "gratë vihen nën presion për të votuar në një mënyrë të caktuar" ekziston. Ndërkohë, kur pyeten për përvoja personale, rreth 95% e femrave të intervistuar pohojnë se ato u ndjenë "plotësisht të lira" për të votuar cilindo që dëshironin.

Një kontradiktë e tillë mund të shpjegohet ose nga fakti që femrat nuk duan të pranojnë se ndjejnë personalisht presion nga meshkujt e familjes (duke mbrojtur kështu familjen nga një imazh negativ që kjo gjë mund të sjellë) ose që "presioni" nuk ndihet personalisht sepse nuk ekziston një opinion politik që kundërshton atë të anëtarëve meshkuj të familjes. Nga diskutimet në grupe, ka më shumë gjasa të jetë kjo e fundit.

Fig. 9 Për aq sa jeni në dijeni, sa shpesh ndejnë gratë në Shqipëri presion nga anëtarët meshkuj të familjeve të tyre për të votuar për një parti apo kandidat të caktuar?

Overall & Breakdown by Gender





Fig. 10 Për aq sa jeni në dijeni, sa shpesh ndejnë gratë në Shqipëri presion nga anëtarët meshkuj të familjeve të tyre për të votuar për një parti apo kandidat të caktuar? Vetëm ata që u përgjigjën "Shpesh" dhe "Shumë shpesh"

Total & Ndarja sipas Gjinisë



“Karizma e liderit të Partisë” kryeson listën e faktorëve që influencojnë zgjedhjen e votuesit. “Shërbimet që partitë politike ofrojnë për familjen e votuesit” është faktori i dytë më i rëndësishëm që influencon votën, gjë që tregon për një qasje tejet pragmatike të fokusuar tek përfitimet.

Të intervistuarit u pyetën për faktorët që influencojnë zgjedhjet e tyre për partitë politike. Ata mund të zgjidhnin tre më të rëndësishmet mes listave të faktorëve të paraqitur.

Faktori i parë më i rëndësishëm që influencon zgjedhjen e votuesit për partitë politike është “Karizma/personaliteti i liderit” (zgjedhur nga 21% e të intervistuarve). Rreth 18% e të intervistuarve përmendin “platformën e partisë politike”, një alternativë politikisht më korrekte se faktori i parë më kryesor. Një 18% thonë se “shërbimet që partitë politike ofrojnë për familjen time” është faktori kryesor që influencon zgjedhjen e votuesit. Kjo shifër është tejet e rëndësishme sepse tregon një qasje tejet pragmatike për një numër të konsiderueshëm të shqiptarëve të fokusuar në përfitime personale.

Këto rezultate tregojnë se për banorët e zonave rurale “shërbimet që partitë politike ofrojnë për familjen time” është faktori i parë më i rëndësishëm që influencon votën e tyre, me 20% të cilët kanë zgjedhur këtë opsion (Fig. 12). Edhe më tej, 24% e femrave të intervistuar në zonat rurale pretendojnë se ky është faktori i parë më i rëndësishëm. Këto gjetje janë tregues të “premtimit të votës në këmbim për përfitimeve personale apo familjare” dhe tregojnë se ky fenomen ka ndodhur në shumicën e këtyre zonave.

Fig. 11 Cilët janë faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në zgjedhjen tuaj të partive politike? Zgjedhja e parë

Total & Ndarja sipas gjinisë





Fig. 12 Cilët janë faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në zgjedhjen tuaj të partive politike? Zgjedhja e parë

Ndarja Urban-Rural, Femrat



Shqiptarët pretendojnë se votat ende premtohen në këmbim të favoreve të ndryshme gjatë fushatave zgjedhore. Në shumicën e rasteve, sipas të intervistuarve, votat janë premtuar në këmbim të punësimit dhe parave. Perceptimi tek të intervistuarit është se ky është një fenomen i përhapur dhe i ditur, veçanërisht në zonat rurale.

Rreth 43% e të intervistuarve deklarojnë se janë në dijeni të rasteve kur votat janë premtuar në këmbim të dhuratave/parave/punësimit apo favoreve të tjera (Fig. 13). Nuk ka ndryshime midis meshkujve dhe femrave të intervistuar në këtë rast.

Rastet më të shpeshta të “premtimit të votave” janë në këmbim të “parave”, “ruajtja e vendit të punës” ose “premtimit për punësim pas zgjedhjeve”. Pothuajse 1 në 3 të intervistuar pohojnë se premtimi i votave ka ndodhur shpesh gjatë zgjedhjeve të fundit (Fig. 14).

Shumë pjesëmarrës në grupet e diskutimit gjithashtu pranojnë se u janë ofruar para, një punë e re apo një më e mirë në këmbim të votave të tyre. Nëse nuk u janë ofruar personalisht favore, ata/ato kanë dëgjuar të paktën për histori të ngjashme nga miq dhe të afërm.

Pjesëmarrësit e Grupeve të Diskutimit përmendin shembuj konkretë ku:

- o Njerëz të angazhuar në parti politike/me kandidatë politikë, i kanë vizituar në qytetet, fshatrat apo shtëpitë e tyre për tu premtuar para dhe punësim në këmbim të votave.

Grupet e Diskutimit:

Ata [përfaqësuesit e partive politike] erdhën dhe na premtuan gjëra. Mua më thanë se do fushnin vajzën në punë. Unë u thashë po. Më thanë se pas zgjedhjeve vajza do fillonte punë..” (Tiranë, Urban)

[A janë ofruar para në këmbim të votive në zgjedhje e kaluara?] Po, ka ndodhur. U ka ndodhur djemve të mi por ata refuzuan. U kanë ofruar para. Çunat e mi e refuzuan.” (Tiranë, Rural)
- o Njerëz të angazhuar politikisht, që qëndronin jashtë qendrave të votimit bindin votuesit që të votojnë në një mënyrë të caktuar në këmbim të favoreve të ndryshme/parave.
- o Njerëz që punojnë në administratë publike shpesh kanë pasur presion për të votuar një parti të caktuar në mënyrë që të ruanin vendin e punës.
- o Njerëz që siguronin transportin dhe para/favore për të bindur votuesit të votojnë në një mënyrë të caktuar (veçanërisht në zonat rurale ku të moshuarit kanë lëvizshmëri të kufizuar për të votuar)

Fig. 13 Nga eksperiencia juaj, a mund të më thoni nëse jeni në dijeni të ndonjë rasti ku votat janë premtuar në këmbim të dhuratave, parave, punësimit apo ndonjë favori tjetër

Total & Ndarja sipas gjinisë





Fig. 14 A ishte vota në këmbim të...?



3.3 PJESËMARRJA E GRAVE NË POLITIKË

A kanë gratë aftësitë e duhura për të vendosur për çështjet politike? Shumica e pjesëmarrësve janë përgjigjur pozitivisht. Megjithatë, përsëri 1 në 6 beson se gratë nuk i kanë këto aftësi. Kjo pjesë e të intervistuarve beson se është burri ai që duhet të vendosi për gruan për çështjet politike. 1 në 3 meshkuj dhe 1 në 5 femra të intervistuar nuk mendojnë se “burri dhe gruaja kanë të njëjtat aftësi për vendimmarrje”.

Rreth 87% e të intervistuarve besojnë se gratë kanë aftësitë e duhura për të vendosur për çështjet politike. Për sa i përket ndarjes gjinore, përsëri 16% e të intervistuarve meshkuj besojnë se gratë nuk i kanë këto aftësi. Të intervistuarat femra i janë përgjigjur pozitivisht kësaj pyetjeje në numra të lartë (91% janë dakord se gratë kanë aftësitë e duhura për të vendosur). Megjithatë, është interesante të vihet re se midis femrave 7% nuk janë dakord me këtë pohim. (Fig. 15).

Të pyetura përsëri nëse gratë janë të afta “për të marrë vendimin e tyre për kë do të votojnë”, 11% e meshkujve nuk janë dakord, ndërsa 5% pohojnë se “nuk e dinë”. Situata ndryshon tek pjesa e femrave të anketuara. Rreth 93% e tyre janë dakord me pohimin dhe vetëm 4% nuk janë dakord. (Fig. 16).

Një shifër e konsiderueshme prej 29% e të intervistuarve nuk mendojnë se “Meshkujt dhe femrat nuk kanë të njëjtat aftësi vendimmarrje”. Gjithashtu ka 20% të femrave të intervistuarve të cilat nuk kanë besim në gjininë e vetë kur vjen puna për aftësitë vendimmarrëse.

Fig. 15 A jeni dakord me pohimet e mëposhtme?





Fig. 16 A jeni dakord me pohimet e mëposhtme



Shumica e Shqiptarëve do të mbështesnin një përfshirje më të lartë të grave në politikë dhe vendimmarrje. Përgjithësisht, të intervistuarat femra besojnë së një numër më i lartë i femrave në politikë do të përmirësonte pozitën e tyre socio-ekonomike në vend.

Të intervistuarit u pyetën se në çfarë mase do ta mbështesnin apo kundërshtonin përfshirjen e grave në politikë. Gati 64% e tyre pohojnë se do ta “mbështesnin fuqimisht”, ndërsa 28% pohojnë se do ta “mbështesnin deri diku” (Fig. 17). Vetëm një pjesë e vogël prej 7% e të anketuarve do të kundërshtonin përfshirjen e grave në politikë.

Përqindja e të intervistuarave femra që e “mbështesnin fuqimisht” përfshirjen e tyre në politikë është 70%, ndërsa shifra për të njëjtin dimension për meshkujt është 58%. Intensiteti i shkallës së mbështetjes tregon se edhe pse ka një mbështetje të përgjithshme në publik për këtë rol të grave, nuk ka gjithsesi një “mbështetje të fuqishme” për këtë rol nga ana e meshkujve.

Të përballur me skenarin hipotetik të “të pasurit një vajzë që do të garojë në zgjedhjet lokale apo parlamentare”, rreth 64% e të intervistuarve deklaruan se do ta “mbështesnin fuqimisht” këtë gjë (Fig 18). Më shumë femra (68%) do ta mbështesnin vajzën e tyre në këtë rast, në krahasim me meshkujt (59%).

Grupet e Diskutimit:

“Unë mendoj se duhet të ketë më shumë gra se sa meshkuj të përfshirë në politikë. Gratë janë të sigjerta dhe të pastërta. Ato janë më afër problemeve tona dhe e kuptojnë më mirë familjen” (Tiranë, Urban)

“Duhet të ketë më shumë gra të përfshira në politikë sepse ato do ti marrin më shpesh në konsideratë problemet e grave.” (Fier, Urban)

Shumica e pjesëmarrësve në Grupet e Diskutimit deklarojnë se do ta mbështesnin fuqimisht përfshirjen e një femre (të afërme të tyre, mikeshë, apo familjare) në politikë. Ata e perceptojnë këtë rol si mjaft pozitiv dhe e shikojnë si një mundësi për tu përfaqësuar më mirë. Në përgjithësi, pjesëmarrësit besojnë së duhet të ketë më shumë femra pjesë të politikës dhe institucioneve vendimmarrëse. Në përgjithësi, pjesëmarrësit besojnë se më shumë femra duhet të jenë pjesë e politikës dhe institucioneve vendimmarrëse. Ka një tendencë për të menduar se gratë në pushtet janë më të afrueshme se sa meshkujt, përse i përket komunikimit dhe aftësisë për të trajtuar çështje të caktuara.

Fig.17 Në çfarë shkalle e mbështesni apo kundërshtoni përfshirjen e grave në politikë?

Total & Ndarja sipas gjinisë





Fig.18 Në çfarë shkalle do ta inkurajonit vajzën për t’u përfshirë në politikë si kandidate në zgjedhjet Lokale/Parlamentare?

Total & Ndarja sipas Gjinisë



Ndërkohë që shumica e Shqiptarëve do të mbështesnin gratë në pozicione të ndryshme publike si Kryebashkiake apo Kryeministre, ka ende një pjesë të konsiderueshme të popullatës që mendon se “meshkujt janë udhëheqës politikë më të mirë se sa gratë”.

Në total, ka një mbështetje të fuqishme tek të intervistuarit, për gratë që janë në pozicione të ndryshme të rëndësishme. Pothuajse 60% e të intervistuarve do ta “mbështesnin fuqimisht” një grua si Kryebashkiake, si Presidente, si Kryetare e Parlamentit apo edhe si Kryeministre (Fig. 19). Ka një nivel të ngjashëm mbështetje për gratë si anëtare të parlamentit, si Ministre apo Kryetare të Partive Politike. Ka një mbështetje disi më ulët për gratë “që punojnë për një kandidat gjatë fushatës zgjedhore” (53% do ta “mbështesnin fuqimisht”) dhe për gratë që “marrin pjesë në protesta politike” (51% do të “mbështesnin fuqimisht”).

Duke marrë parasysh ndarjen gjinore, niveli i mbështetjes së shprehur nga të intervistuarat femra është shumë më i fortë se sa ai i shprehur nga të intervistuarit meshkuj (Fig. 20). Rreth 1 në 5 meshkuj kundërshton “pjesëmarrjen e grave në protesta politike” dhe 1 në 7 meshkuj kundërshton “gratë që punojnë për një kandidat gjatë një fushatë”. Në total, mbështetja e të intervistuarve meshkuj për postet e ndryshme të zëna nga femrat është 10-11% më pak se mbështetja e treguar nga femrat e intervistuarat.

Fig. 19 Në çfarë shkalle e mbështesni ose kundërshtoni rolin e grave në pozicionet e mëposhtme?





Fig. 20 Në çfarë shkalle e mbështesni ose kundërshtoni rolin e grave në pozicionet e mëposhtme?



Të intervistuarit u pyetën se deri në çfarë mase bien ose jo dakord me disa pohime specifike për aftësitë drejtuese të femrave krahasuar me ato të meshkujve.

Në total, rezultatet tregojnë se ka një besim të rrënjosur thellë në më shumë se gjysmën e popullsisë, se gratë nuk mund të krahasohen me meshkujt kur flitet për cilësitë e udhëheqësit. Rreth 46% e të intervistuarve mendojnë se “meshkujt janë lidera më të mirë politik se sa femrat”.

Rreth 58% e meshkujve të intervistuar janë dakord se “në tërësi, meshkujt janë udhëheqës më të mirë politikë se sa gratë”, ndërsa 41% e tyre nuk bien dakord me të. Një pjesë e konsiderueshme e femrave të intervistuar (31%) gjithashtu janë dakord me një pohim të tillë, ndërsa 64% e tyre nuk janë dakord.

Dakordësia mbi faktin se “meshkujt janë më të aftë se sa gratë” është edhe më e fortë kur pyeten mbi marrëdhënien me pozicionet ekzekutive në biznes. Pothuajse 2 në 3 meshkuj (65%) mendojnë se “burrat janë drejtues me të mirë në biznes se sa gratë”. Një numër i konsiderueshëm i femrave të anketuara mendojnë të njëjtën gjë (43%).

Fig.21 Në përgjithësi, meshkujt janë drejtues më të mirë politik se femrat?

Total & Ndarja sipas Gjinisë





Fig. 22 Në përgjithësi, meshkujt janë drejtues më të mirë biznesi se femrat?

Total & Ndarja sipas Gjinisë



Shqiptarët nuk janë të informuar siç duhet mbi qëllimin e kuotave gjinore në politikë apo edhe për zbatimin e tyre. Vetëm 1 në 2 persona e di se partitë politike janë të detyruara të rezervojnë të paktën 30% të listës së kandidatëve për femrat. Të tjerët, ose nuk janë në dijeni, ose kanë informacionin e gabuar për kuotën.

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë përcakton se partitë politike duhet të rezervojnë të paktën 30% të listës së kandidatëve për gratë. Gjatë sondazhit janë bërë pyetje për të eksploruar nëse publiku i gjerë është në dijeni të një përcaktimi të tillë ligjor. Rreth 47% e të intervistuarve pohojnë sakstësisht se detyrimi ligjor i partive është të rezervojnë 30% të listës së kandidatëve për femrat. Rreth 27% deklaruan se nuk kanë dijeni për asnjë kuotë gjinore. Gati 11% deklaroi se sipas ligjit nuk ka kufizime bazuar në gjini. Është gjithashtu një pjesë e të intervistuarve (15%) që mendon se kuota gjinore bazuar në ligj është 50%.

Një fakt interesant është se meshkujt dinë më shumë për përcaktimet ligjore të kuotave gjinore krahasuar me femrat. Rreth 53% e të intervistuarve meshkuj ishin të saktë kur përmenden kuotat gjinore prej 30%, ndërsa 41% e femrave të intervistuar mundën të bënin të njëjtën gjë. Pothuajse 1 në 3 femra nuk është në dijeni të kuotave gjinore të përcaktuara nga ligji.

Të intervistuarit e zonave urbane janë më në dijeni për kuotat gjinore (50% përmendin shifrën e saktë) se sa ata të zonave rurale (43% përmendin shifrën e saktë)

Përgjithësisht ka një mbështetje të lartë për përfshirjen e kuotave gjinore në politikë apo institucionet e zgjedhura. Rreth 83% e të intervistuarve do të mbështesnin këto kuota me 45% që do të "mbështesnin fuqimisht" dhe 38% që do të "mbështesnin deri diku". Vetëm 9% e të intervistuarve do të kundërshtonin këto kuota (Fig 24.)

Fig.23 Bazuar në informacionin që keni, cilët nga pohimet e mëposhtme janë të vërteta?

Total & Ndarja sipas Gjinisë





Fig. 24 Në çfarë mase e mbështesni apo kundërshtoni futjen e kuotave gjinore në politikë/institucionet e zgjedhura në Shqipëri?

Total & Ndarja sipas Gjinisë



Të intervistuarve u është bërë një seri pyetjesh në lidhje me kuotat gjinore. Atyre iu paraqit një listë me pohime për të parë nëse janë apo jo dakord me to.

Është interesante të vihet re se një numër i konsiderueshëm i të intervistuarve ende mendon se “Kuotat gjinore janë një mjet artificial për të rritur pjesëmarrjen e grave në politikë”. Rreth 30% e të intervistuarve “janë dakord” me këtë pohim dhe një 4% tjetër janë “plotësisht dakord” me të. Interesant është fakti se edhe 31% e femrave të intervistuarra janë dakord me këtë pohim. Një shifër e tillë tregon se megjithëse ka një mbështetje përgjithësisht të lartë për futjen e kuotave gjinore në politikën shqiptare, për një pjesë të konsiderueshme të popullatës, kjo është më tepër një çështje e të qenit “politikisht korrekt” sesa një çështje tek e cila ata/ato besojnë. Edhe në Grupet e Diskutimit kishte një rezistencë kundrejt futjes së kuotave gjinore. Kishte diskutime midis pjesëmarrësve të cilët pohonin se “ritja artificiale e grave në politikë nuk sjell domosdoshmërisht një performancë më të mirë të institucioneve në të cilat ato zgjidhen”.

Për rreth 28% e të intervistuarve “Kuotat gjinore nënkuptojnë se politikanët zgjidhen bazuar në gjini dhe jo kualifikimet”. Një opinion i tillë, me një ndjenjë më të fortë të meshkujve (31%) në krahasim me femrat (26%), është një “hap tjetër” për ta bërë opinionin publik ta pranojë plotësisht si dhe të ushtroj presion tek partitë politike për të zbatuar kuotat gjinore. Është një çështje tek e cila duhet fokusuar gjatë aktiviteteve të edukimit dhe informimit për të promovuar pjesëmarrjen politike të grave.

Të intervistuarit janë dakord gjerësisht me pohimet sipas së cilave “Kuotat gjinore do të përforcojnë rolin e grave në politikë” (87%) dhe “Gratë e zgjedhura do të fokusohen në politika/çështje të reja si shëndetësia, edukimi i fëmijëve etj)” (83%).

Vetëm 38% e të intervistuarve janë dakord që “Kuotat për gratë do të inkurajonin kuotat edhe për grupe të tjera”. Një numër i ngjashëm, 37%, nuk janë dakord me këtë pohim, ndërkohë që 25% “nuk e dinë”.

Fig. 25 Në çfarë mase jeni dakord me pohimet e mëposhtme?
I gjithë Kampioni





Fig. 26 Në çfarë mase jeni dakord me pohimet e mëposhtme?
Femrat



3.4 LIRIA E GRAVE

Shumica e femrave në Shqipëri ndihen të lira për tu shoqëruar me njëri-tjetër të zgjedhur nga ato vetë, për të shprehur pikëpamjet mbi çështje kritike tek anëtarët e familjes si dhe deri në njëfarë mase, për të ecur pa frikë apo presion në hapësira publike. Ato ndihen më pak të lira për të dalë nga shtëpia pa leje. Një numër i konsiderueshëm i grave varen ende financiarisht nga të ardhurat e familjes/partnerit.

Një seri pyetjesh u kryen gjatë sondazhit për të zbuluar dimensionet e ndryshme të lirisë së grave.

Të pyetura se sa të lira ndihen për tu “shoqëruar me personat e zgjedhur prej tyre”, rreth 69% e femrave deklarojnë se ndihen “plotësisht të lira”. Një 19% tjetër pohojnë se ndihen “deri diku të lira” ndërkohë që vetëm 8% ndihen të kufizuara. Një situatë e ngjashme paraqitet edhe kur ato pyeten mbi “shprehjen e pikëpamjeve të tyre mbi çështjet kritike të anëtarëve të familjes, komshinjeve apo miqve”. Rreth 69% pohojnë se ndihen “plotësisht të lira” dhe 21% “Deri diku të lira”. Vetëm 6% deklarojnë se ndihen të kufizuara në këtë aspekt.

Përsa i përket “të ecurit në hapësira publike pa frikë apo presion”, rreth 53% e femrave të intervistuar pohojnë se ndihen “plotësisht të lira” ndërsa një 29% tjetër deklarojnë se ndihen “deri diku të lira”. Rreth 16% e femrave të intervistuar ndihen të kufizuara në këtë aspekt. Gjëndja është edhe më e keqe kur analizojmë rezultatet për pyetjen “Të larguarit nga shtëpia pa leje”. 1 në 3 e të femrave të intervistuar (31%) ndihet e kufizuara në këtë aspekt. Vetëm 35% e tyre ndihen “plotësisht të lira” dhe një tjetër 31% ndihen “deri diku të lira”.

Sondazhi gjithashtu pyeti femrat e intervistuar nëse ato do të ishin në gjendje të mbështesnin veten/familjen nëse nuk do të vareshin më nga të ardhurat e bashkëshortit apo familjes. Rreth 38% e tyre pohojnë se “Po”, ato do të ishin në gjendje të mbështesnin veten apo familjen. Një tjetër 7% pohojnë se ato tashmë e mbështesnin vetë familjen. Pjesa tjetër, 55% e femrave të intervistuar ose deklarojnë se nuk janë në gjendje ta mbështesnin, ose se nuk janë të sigurt në lidhje me pohimin.

Fig. 27 Në çfare mase ndiheni të lira apo të kufizuara në veprimet e mëposhtme?





Fig. 28 Nëse nuk do të ishte më e mundur të mbështetëshin tek të ardhurat e burrit apo familjes suaj, a do të mund të mbështesni veten financiarisht?



4. Komuniteti Rom

4.1 Informacion i përgjithshëm

Komuniteti Rom shfaq një interes shumë të dobët në politikë, shumë më të dobët se ai i pjesës tjetër të popullsisë. Ashtu si dhe për pjesën tjetër të popullsisë, por më një intensitet më të lartë, varfëria, ekonomia, dhe papunësia janë midis shqetësimeve kryesore për komunitetin Rom.

Popullsia Rome tregon një interes shumë të dobët mbi çështjet politike dhe ato të qeverisë. Vetëm 20% shfaqin interes (6% “Shumë të interesuar” dhe 14% “Deri diku të interesuar”). Një përqindje e lartë e tyre (78%) pohojnë se nuk janë të interesuar për politikën. Interesi i popullsisë Rome për politikën është shumë më i ulët krahasuar me rezultatet e popullatës së gjerë. Rreth 48% e popullatës së gjerë deklarojnë se kanë një lloj interesi, krahasuar me vetëm 20% të komunitetit Rom.

Varfëria sipas popullatës Rome është problemi më i vështirë më të cilin përballet vendi. Ky është një rezultat i pritshëm për arsye se me sa duket, ata i projektojnë problemet/vështirësitë e tyre si “problemin e gjithë vendit”.

Problemet ekonomike dhe papunësia gjithashtu u përmenden nga popullata Rome si problemet më të vështira të vendit, por ndryshimi qëndron tek renditja e këtyre problemeve nga popullata Rome. Varfëria është problemi më i vështirë për 34% të të intervistuarve Rom, krahasuar me 9% të popullatës së gjerë.

Fig. 29 Sa të interesuar jeni për çështjet politike apo të qeverisë?





Fig. 30 Cili është problemi më i madh me të cilin përballet vendi?



Komuniteti Rom shfaq një ndjenjë shumë të dobët të përfshirjes civile. Shumë pak pjesëtarë të këtij komuniteti janë anëtarë të partive politike apo organizatave të shoqërisë civile. Një numër i madh i Romëve pohojnë se nuk përdorin asnjë instrument/mjet për të shprehur pikëpamjet e tyre rreth çështjeve politike apo sociale.

Vetëm 2% e të intervistuarve Rom pranojnë se janë aktualisht anëtarë të partive politike. Ky është një numër shumë i vogël krahasuar me popullatën e gjerë (11%). Ajo çfarë është interesante është fakti se, edhe pse në nivele të vogla, ka një numër më të lartë të anëtarëve të komunitetit Rom që deklarojnë se janë pjesë e organizatave fetare, krahasuar me pjesën tjetër të popullatës (8% e komunitetit Rom krahasuar me 3% të popullatës së gjerë). Në mënyrë të ngjashme, rreth 6% e Romëve deklarojnë se aktualisht janë anëtarë apo të angazhuar me OJF, ndërsa përqindja është afër zeros për popullatën e gjerë. Edhe pse shifra të ulëta, vihet re se ekziston një përpjekje për të organizuar popullatën Rome në terren.

Romët u pyetën gjithashtu nëse kanë kryer ndonjë nga aktivitetet specifike të listuara për të shprehur pikëpamjet e tyre. Duke konsideruar aktivitetet e listuara, përqindja e Romëve të cilët kanë kryer apo mund të kryejnë ndonjë nga këto aktivitete është shumë më e ulët se sa ajo e popullatës së përgjithshme. Rreth 12% e të intervistuarve Rom deklarojnë se nuk kanë kontaktuar apo vizituar kurrë një zyrtar publik gjatë 12 muajve të fundit krahasuar me 18% të popullatës së përgjithshme të cilët e kanë kryer një gjë të tillë. Për më tepër, 54% e të intervistuarve Rom thonë se nuk do të kontaktonin kurrë me zyrtarë publik për të shprehur opinionet e tyre, krahasuar me 34% të kampionit të Popullatës së Përgjithshme.

Përdorimi i rrjeteve sociale për të shprehur opinionet politike ose sociale tek Romët është vertet i ulët. Vetëm 2% pranojnë se i kanë përdorur gjatë 12 muajve të fundit (krahasuar me 7% të popullatës së gjerë).

Në mënyrë të ngjashme, Romët nuk telefonojnë aspak në shfaqje televizive dhe nuk i përdorin fare peticionet.

Fig. 31 A mund të më thoni nëse jeni apo keni qënë anëtar i ndonjërës prej organizatave të ndryshme të listuara këtu?





Fig. 32 A keni kryer ndonjërin prej këtyre aktiviteteve më poshtë për të shprehur bindjet tuaja?



4.2 VOTIMI FAMILJAR DHE SJELLJA E VOTUESIT

“Personaliteti/karizma i udhëheqësit është faktori më i rëndësishëm që influencon vendimin e pjesëtarëve të komunitetit Rom në ditën e zgjedhjeve. Ata deklarojnë që nuk ndjenë asnjë lloj presioni për të votuar në një mënyrë të caktuar. Treguesi i “Votimit Familjar”, gjatë të cilit “individët shoqërohen nga dikush drejt kutive të votimit”, është më i lartë midis femrave Rome në krahasim me femrat e popullatës së gjerë.

Rreth 40% e popullatës Rome mendon se “Personaliteti/Karizma e udhëheqësit” është faktori më i rëndësishëm që influencon votën e tyre. Kjo shifër është shumë më e lartë krahasuar me faktorët e tjerë si “Platforma e partisë politike” (12%), “Shërbimet që i ofron partia politike familjes” (11%) apo “Shërbimet që ofron partia politike për lagjen time”.

Krahasimi i këtij rezultati me kampionin e popullatës së përgjithshme nxjerr në pah se për komunitetin Rom, “Karizma e udhëheqësit” është më shumë e rëndësishme (39% kundrejt 21% të popullatës së përgjithshme). Potencialisht kjo tregon një probabilitet më të lartë që kjo pjesë e popullsisë të manipulohet nga këta udhëheqës karizmatik.

Rreth 78% e të intervistuarve Rom pohojnë se votuan në Zgjedhjet e 2013, ndërsa 23% nuk e bënë një gjë të tillë (Fig. 34). Numri i atyre që nuk votuan është më i lartë se tek popullata e përgjithshme (12%), një tregues tjetër i mungesës së interesit për politikën nga komuniteti Rom.

Edhe në kampionin Rom është e qartë që nuk ka pasur një presion të drejtpërdrejtë dhe të dukshëm për zgjedhjen në votime. Rreth 87% e të intervistuarve Rom pohojnë se u ndjenë “plotësisht të lirë” për të votuar këdo që donin dhe një 6% tjetër është ndjerë “deri diku e lirë”. Vetëm 3% deklaruan se ata janë ndjerë disi nën presion për të votuar për një parti ose kandidat të caktuar.

Fig. 33 Cili nga faktorët më poshtë ndikon më shumë në zgjedhjen tuaj? I pari i Përmendur





Fig. 34 A votuat në zgjedhjet e Përgjithshme të 2013?



Pothuajse 1 në 5 femra Rome të intervistuar deklarojnë se janë shoqëruar nga dikush në dhomën e votimit për zgjedhjet e 2013. Kjo shifër është më e lartë se ajo e femrave të intervistuar nga popullata e përgjithshme që deklaruan të njëjtën gjë (7%). Në 71% të rasteve, ka qënë një anëtar mashkull ai që ka shoqëruar gratë Rome.


Kjo tregon se potencialisht fenomeni i “Votimit Familjar” përmes metodës direkte të “shoqërimit të bashkëshortes/vajzës/motrës në dhomën e votimit” dhe votimi në emër të tyre mund të jetë më i lartë tek komuniteti Rom sesa tek popullata e përgjithshme. Megjithatë, vlen të theksohet se analfabetizmi, një nga arsytet për të cilat lejohet që dikush të jetë i shoqëruar në dhomën e votimit, tek komuniteti Rom është më i lartë.

Rreth 12% e të intervistuarve Rom pohojnë se komisionet e votimit lejuan më shumë se një person në dhomën e votimit gjatë Zgjedhjeve të 2013. Kjo shifër është më shumë se dyfishi i asaj të deklaruar nga të intervistuarit e kampionit të popullatës së përgjithshme (5%). Megjithatë, vlen të theksohet se gjeografikisht, kampioni Rom i referohet vetëm zonave të banuara nga Romët¹⁴ dhe në këtë mënyrë nuk përfaqëson të gjitha zonat e vendit me qendrat përkatëse të votimit.

Fig. 35 A ju shoqëroi ndonjë anëtar i familjes në dhomën e votimit në këto zgjedhje? Kush?

Femra Rome

Femra Rome
N = 93



N = 17





Fig. 36 A lejoi komisioni në qendrën tuaj të votimit (QV) më shumë se 1 person në dhomën e votimit gjatë zgjedhjeve 2013?

Romë
N = 200



14. Siç është shpjeguar në pjesën e metodologjisë përsa i përket kampionit Rom

Në përgjithësi, gratë e komunitetit Rom ndihen më pak të lira se gratë e popullatës së përgjithshme. Rreth 24% e femrave Rome deklarojnë se ndihen të kufizuara për tu "shoqëruar me persona që ato do zgjidhnin vetë" (Fig. 37) krahasuar me vetëm 8% të intervistuarave nga kampioni i popullatës së përgjithshme¹⁵. Në mënyrë të ngjashme, femrat e komunitetit Rom ndihen më të kufizuara për të ndarë pikëpamjet personale me rrethin familjar, fqinjëtd dhe shoqërinë ku ato bëjnë pjesë (20% femra Rome ndihen të kufizuara kundrejt 6% të atyre nga popullata e përgjithshme).

Kufizimi më i madh që femrat Rome kanë është "largimi pa marrë leje nga shtëpia". Rreth 54% e tyre deklarojnë se ndihen të kufizuara në këtë aspekt, në krahasim me 31% të femrave të intervistuar nga popullata e përgjithshme.

Krahasuar me popullatën e përgjithshme, ka një numër më të madh Romësh që nuk kanë besim se:

- i) femrat janë në gjendje të vendosin vetë për kë do votojnë (14% e të intervistuarve Rom kundrejt 4% të popullatës së përgjithshme)¹⁶
- ii) femrat i kanë të gjitha aftësitë për të gjykuar mbi çështje të ndryshme politike (17% e të intervistuarve Rom, kundrejt 6% të kampionit të popullatës së përgjithshme).

Një numër më i madh nga komuniteti Rom gjithashtu mendon se meshkujt duhet të marrin vendime në vend të grave në lidhje me çështjet politike (36% e komunitetit Rom kundrejt 13% të kampionit të popullatës së përgjithshme)

Fig. 37 Në çfare mase ndiheni të lira apo të kufizuara në veprimet e mëposhtme?





Fig. 38 Në çfarë mase jeni ose nuk jeni dakord me pohimet e mëposhtme?



15. Shiko grafikun për krahasim

16. Shiko grafikun për krahasim

Pjesa më e madhe e komunitetit Rom ose nuk i dinë kushtet për kuota gjinore, ose nuk janë në gjendje ti përcaktojnë saktë ato. Mungesa e ndërgjegjësimit mbi këtë çështje te komuniteti Rom është me e lartë se te kampioni i popullatës së përgjithshme.

Afërsisht 53% e të intervistuarve Rom nuk dinë për ligjin elektoral në lidhje me kuota gjinore të listës së kandidatëve (Fig. 39). Gjithashtu 7% prej atyre mendojnë se ligji elektoral nuk ka kufizime gjinore, ndërkohë që 12% mendojnë se kërkesa për kuota gjinore në listat e kandidatëve të partive politike është në nivelin 50%.

Të pyetur për mbështetjen për një seri pohimesh të lidhura me kuota gjinore, rreth 63% të të intervistuarve Rom deklauar mbështetje, ndërsa një e treta e të intervistuarve nuk dinin se çfarë përgjigje të jepnin (29%).

Intensiteti i përgjigjeve “Nuk e di” edhe për një seri pohimesh të lidhura me kuota gjinore është shumë më i lartë se tek pjesa tjetër e popullsisë. Janë afërsisht 1/3 e të intervistuarve Rom të cilët kur u pyetën nëse binin dakord apo jo me këto pohime thanë se “Nuk e dinë” (Fig.40).

Fig. 39 Bazuar në informacionin që keni, cilët nga pohimet e mëposhtme janë të vërteta?





Fig. 40 Në çfarë mase bini ose jo dakord me pohimet e mëposhtme?

Kampioni Rom



Rekomandimet

Çfarë sugjerimesh mund të ketë për të luftuar votimin familjar në Shqipëri, dhe për të lejuar gratë votuese të ushtrjnë të drejtën e tyre lirisht? Si mund të fuqizohen votueset femra për të marrë vendime të pavarura?

Votimi Familjar

- Ekziston një nevojë e dukshme për qeverinë që të përgatisi një strategji kombëtare të adresuar tek fenomeni i “Votimit Familjar” dhe rrënjët e tij. Megjithatë strategjia duhet të jetë e shtrirë në nivel kombëtar, ajo duhet të fokusohet më tepër në ato zona në të cilat fenomeni vihet re më shpesh (zonat rurale, të largëta).
- Duhet t’i jepet prioritet hartimit dhe zbatimit të fushatave sensibilizuese për reduktimin e fenomenit të votim familjar me të gjithë votuesit. Megjithatë, fushatat sensibilizuese duhet të marrin në konsideratë faktin që fenomeni i votimit familjar injorohet më së tepërmi në zonat rurale dhe në disa qarqe të veçanta të Shqipërisë. Për të reduktuar fenomenin e votimit familjar duhen luftuar arsyet që mbështesin ekzistencën e këtij fenomeni, në mënyrë të veçantë mendësitë sipas së cilave vajzat dhe gratë janë të paafta për të marrë vendime politike. Gjetjet e studimit sugjerojnë se duhen hartuar dhe zbatuar politika të cilat vënë theksorë aftësitë e gruas për të marrë vendime. Këto politika duhet t’i drejtohen njëherazi grave dhe burrave. Nga njëra anë, gratë kanë nevojë të besojnë në aftësitë e tyre për të marrë vendime në mënyrë të pavarur. Nga ana tjetër, burrat nuk duhet të mbështeten stereotipe dhe të besojnë në aftësitë vendim-marrëseve të partnereve, motrave apo vajzave të tyre.
- Këto politika duhet gjithashtu të marrin në konsideratë dallimet midis personave me nivel të ndryshëm arsimor. Mungesa e besimit në aftësitë vendim-marrëse të grave është më e përhapur tek të intervistuarit e zonave rurale dhe tek personat pa arsim ose me arsim tetë-vjeçar. Gjetjet e studimit sugjerojnë që popullata me këtë profil duhet të jetë më në fokus të fushatave të sensibilizimit.
- Një fokus i veçantë duhet të dedikohet popullatës Rome, për sa i përket fenomenit të “Votimit Familjar”. Masa të dedikuara për të rritur sensibilizimin duhet të hartohen për këtë pjesë të popullsisë, tek e cila fenomeni injorohet më së tepërmi.
- Votimi Familjar si fenomen është një shqetësim i cili duhet të adresohet nga një numër aktorësh në shoqëri. Në këtë aspekt, media duhet të jetë më e kujdesshme dhe proaktive në prezantimin e publikut me dizavantazet e votimit familjar dhe efektet e tij. Kanalet mediatike duhet të intensifikojnë fushatat sensibilizuese mbi procedurat e votimit si dhe përcaktimet e kodit zgjedhor, në mënyrë që të informojnë më mirë votuesit për të drejtat dhe përgjegjësitë (si edhe penalitetet ligjore) në ditën e votimit.
- Trajnimet e ofruara nga partitë politike për komisionerët e tyre në qendrat e votimit, duhet të fokusohen më shumë se si të identifikohen dhe më pas të raportojnë rastet e votimit familjar në ditën e votimit.
- Adoptimi i teknologjisë për votimin (votimin elektronik) në të ardhmen duhet të marri parasysh fenomenin e “votimit familjar”, në mënyrë që të përfshij standarde në sistem të cilat nuk do ta lejonin atë në format e vërejtura në ditën e zgjedhjes (një person voton për dikë tjetër).
- Një anëtar i Komisionit Zgjedhor në çdo Qëndër Votimi duhet të angazhohet me përgjegjësinë për të vëzhguar dhe parandaluar Votimin familjar. Prezenca dhe monitorimi aktiv i vëzhguesve ndërkombëtar, monitoruesve jo-partizan lokal, dhe vëzhguesve partiak, në Qendrat e Votimit shërben si pengesë, jo vetëm për zgjedhësit që përpiqen të votojnë

për më shumë se një person, por edhe për vetë zyrtarët e Qëndrave të Votimit të cilët mendojnë të lejojnë një votim të tillë që të ndodhi.

- Ashpërsimi i penalteteve ligjore për përgjegjësit e votimit familjar, si dhe zbatimi i duhur i këtyre penalteteve/gjobave nga KQZ dhe gjyqësori, mund të sjellë një vetëdije më të lartë të votuesve mbi pasojat ligjore të këtij veprimi.

Kuotat Gjinore

- Pranimi i kuotës gjinore kërkon sensibilizimin e të gjithë popullatës në lidhje me rëndësinë e zbatimit të saj dhe veçanërisht të djemve/burrave të cilët sipas gjetjeve tona janë më pak në favor. Në pjesën më të madhe të rasteve, pozicionet vendim-marrëse janë të drejtuara nga burra. Si rrjedhojë, zbatimi dhe pranimi i kuotës për rritjen e përfaqësimit të grave në poste të rëndësishme kërkon mbështetjen e burrave në pozicione kyçe.
- Politikat që synojnë rritjen tek votuesit/et e mbështetjes ndaj kuotës gjinore duhet të konsiderojnë faktin se mbështetja e grave ndaj kuotës gjinore nuk është absolute. Jo të gjitha gratë imbeshtesin kuotat gjinore. Një profil specifik duhet të merret parasysh, (gratë e papuna, gratë në pension, gratë pa arsimin e duhur, etj)
- Një kusht i domosdoshëm për rritjen e mbështetjes publike për kuotat gjinore, është qartësia dhe cilësia e informacionit që i paraqitet publikut mbi qëllimin e kuotave. Votuesit duhet të informohen mbi kriteret e implementimit të kuotave gjinore, të institucioneve ku ato zbatohen, si dhe arsyet pse duhet të zbatohen. Fushatat sensibilizuese duhet të informojnë publikun, veçanërisht meshkujt dhe popullsinë e zonave rurale, se zbatimi i kuotave gjinore nuk do të thotë se do të zgjidhen gratë/vajzat pa kualifiimet e duhura. Në shumicën e rasteve, kundërshtimi i kuotave gjinore lidhet me frikën se gratë/vajzat e zgjedhura përmes kuotave janë të paafta dhe qënia e tyre në pushtet do të krijonte më shumë probleme se sa zgjidhje.
- Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve (KQZ) duhet të jetë më efektive në aplikimin e gjobave dhe ndëshkimeve për partitë politike listat e të cilave nuk i përmbushin përcaktimet gjinore në bazë të kodit zgjedhor. Ashpërsimi i ndëshkimeve dhe gjobave për partitë të cilat nuk i përmbushin kriteret mund të jetë një opsion tjetër, për shkak se gjobat aktuale janë në nivele minimale. Në të njëjtën kohë, KQZ-ja mund të zgjedhë të mos i pranoj listat e kandidatëve të partive të cilat nuk përmbushin kriteret gjinore, duke e bërë kështu të pamundur garimin e këtyre partive në zgjedhje. Kjo padyshim do të ishte një masë drastike dhe ekstreme, por do të shërbente patjetër qëllimit të zbatimit në mënyrën e duhur të kuotave gjinore bazuar në ligj.